


---

# UDHËZUES METODIK PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS SË RE


## ARSIMI FILLOR

## KLASAT I-V

---



[www.ascap.edu.al](http://www.ascap.edu.al)  
[sekretaria@ascap.edu.al](mailto:sekretaria@ascap.edu.al)



**UDHËZUES METODIK**  
**PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS SË RE**

**ARSIMI FILLOR**

**KLASAT I-V**

**TIRANË, 2021**

**Koordinuan konceptimin dhe hartimin Udhëzuesit:**

***Dr. Aurela Zisi, ASCAP dhe Dr. Edlira Sina, ASCAP***

***aurelazisi@yahoo.com; edlirasina@yahoo.com***

**Për pasurimin e udhëzuesit me shembuj dhe raste nga praktika e përditshme e punës, kontribuan mësuesit dhe drejtuesit e arsimit fillor:**

LedinaMustafaj, Gjergji Vangjeli, Anila Tiço, Antoneta Vatnikaj, Irena Çuçi, Rezearta Krasniqi, AlmaDikollari, Laura Shuteriqi, Lumturi Kopani, IrenaNanaj, Entela Ozuni, MonikaHoxhaj, Nereida Myftija, ErmaKuka, Valbona Janaqi, Alma Shyle, Arminda Visha, Ermilda Blida, Valbona Hoxha, M. Teferiçi, Eleni Dhima, Mirela Shahini, Adriana Skenderi, Edlira Stërkeshi, Shqiponja Bilani, Rilinda Imeraj, EglantinaMemelli, ArturMano, Gerinda Ngjela, Rozana Nuzi, Ehsen Kraja, SuadaVokshi, Adriana Skënderi, Evis Shtika, Eliverta Gjolli, Dhurata Cuka, Donika Biba etj.

***Koordinoi redaktimin shkencor***

***Dr. Dorina Rapti***

***Koordinoi redaktimin gjuhësor***

***Erida Koleci***

***Koordinoi faqosjen***

***Esion Zgjana***

***Prodhim i ASCAP-it***

***2021***

# PËRMBAJTJA DHE STRUKTURA E UDHËZUESIT

PËRMBAJTJA DHE STRUKTURA E UDHËZUESIT .....	3
LISTA E TABELAVE.....	5
QËLLIMI I UDHËZUESIT .....	8
PLANI MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR.....	9
ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËRMJET FUSHAVE TË TË NXËNIT .....	12
KOMPETENCAT DHE TEMATIKAT E FUSHAVE TË TË NXËNIT.....	13
FUSHA: GJUHËT DHE KOMUNIKIMI .....	13
FUSHA/LËNDA: MATEMATIKË .....	15
FUSHA: SHKENCAT E NATYRËS.....	15
FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI.....	16
FUSHA: ARTET.....	17
FUSHA: EDUKIMI FIZIK, SPORTET DHE SHËNDETI .....	18
FUSHA: TEKNOLOGJI DHE TIK.....	19
KURRIKULA ME ZGJEDHJE .....	20
PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES.....	21
Llojet e planifikimeve.....	21
Planifikimi vjetor i lëndës .....	22
Planifikimi i tri periudhave.....	23
Planifikimi ditor .....	25
Planifikimi i kurrikulës me zgjedhje.....	29
VLERËSIMI I NXËNËSIT NË ARSIMIN FILLOR.....	31
Vlerësimi i nxënësit në klasat I-III .....	31
Vlerësimi i nxënësit në klasat IV dhe V.....	34
Vlerësimi periodik i nxënësit.....	35

Vlerësimi përfundimtar i nxënësit.....	36
Nota përfundimtare dhe vlerësimi vjetor.....	37
SHËNIMET VLERËSUESE TË MËSUESIT.....	38
DISA SUGJERIME PËR NJË MËSIMDHËNIE TË FRYTSHME.....	41
PROJEKTET KURRIKULARE.....	44
PORTOFOLI I NXËNËSIT.....	47
Organizimi i portofolit të nxënësit për klasat I-III.....	47
Rubrikat e portofolit për klasën IV -V.....	48
Dokumentimi dhe vlerësimi i portofolit të nxënësit në klasat IV-V.....	49
Diskutimi i punimeve dhe i detyrave të portofolit.....	50
Komunikimi i rezultateve të prindërit.....	50
TESTET.....	51
Parimet e hartimit të testeve.....	51
Hartimi i testit.....	52
MODELE PROJEKTESH.....	69
Tema e projektit “Të ushqehemi shëndetshëm”.....	71
Përshkrim i veprimtarive të projektit.....	72
PROJEKT NDËRLËNDOR “NË NDIHMË TË KOMUNITETIT”.....	78
Vlerësimi i projektit kurrikular për klasat IV dhe V.....	81

# LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Plani mësimor i arsimit fillor .....	10
Tabela 2. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Gjuhë shqipe .....	13
Tabela 3. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Gjuhë e huaj.....	14
Tabela 4. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Matematikë .....	15
Tabela 5. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Dituri natyre .....	15
Tabela 6. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Edukim për shoqërinë (klasat I-II), Qytetari (klasat III-V).....	16
Tabela 7. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Histori.....	16
Tabela 8. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Muzikë.....	17
Tabela 9. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Art pamor.....	17
Tabela 10. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Kërcim .....	17
Tabela 11. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Teatër.....	18
Tabela 12. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Edukim fizik, sporte dhe shëndet.....	18
Tabela 13. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: TIK.....	19
Tabela 14. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Aftësim teknologjik praktik.....	19
Tabela 15. Formati i planifikimit mësimor vjetor.....	22
Tabela 16. Formati i planifikimit të periudhës.....	23
Tabela 17. Planifikimi ditor.....	26
Tabela 18. Taksonomia e Blumit.....	27
Tabela 19. Planifikimi i kurrikulës me zgjedhje.....	29
Tabela 20. Planifikimi ditor i kurrikulës me zgjedhje .....	30
Tabela 21. Vlerësimi periodik i nxënësit .....	36
Tabela 22. Vlerësimi vjetor i nxënësit.....	37
Tabela 23. Përlllogaritja e notës përfundimtare në klasat IV-V .....	37
Tabela 24. Shpërndarja e peshave sipas niveleve për klasat I-III dhe IV-V.....	53
Tabela 25. Tabela e specifikimeve (Blueprint-i).....	53

Tabela 26. Intervalet e pikëve të testit për nivelet e vlerësimit në klasat I-III .....	55
Tabela 27. Intervalet e pikëve të testit për notat 4 – 10, në klasat IV-V .....	55
Tabela 28. Model i vlerësimit të një projekti gjithëvjeter.....	81
Tabela 29. Tabelë e vetëvlerësimit të projektit kurrikular nga nxënësi.....	83

*Njohja e dijeve nuk është e mjaftueshme për të pasur sukses  
dhe për t'u përshtatur me botën, e cila zhvillohet me shpejtësi...*

Shoqëria jonë sot ka nevojë për të rinj krijues, të cilët mund të zgjidhin probleme, të marrin vendime, të mendojnë në mënyrë kritike, të komunikojnë ide dhe të bëjnë punë efektive brenda grupeve ku përfshihen.





# QËLLIMI I UDHËZUESIT

Udhëzuesi për zhvillimin e kurrikulës së re synon t'u vijë në ndihmë mësuesve të arsimit fillor, që po e zbatojnë këtë kurrikul. Në këtë dokument, mësuesit gjejnë:

- udhëzime dhe sqarime për zbatimin e kurrikulës së re;
- modele të planifikimit vjetor, të një periudhe dhe të planifikimit ditor;
- udhëzime për vlerësimin e nxënësve;
- modele për kuptimin e temave ndërkurrikulare dhe të projekteve;
- udhëzime për krijimin dhe vlerësimin e portofolit të nxënësit etj.

Ky udhëzues u shërben specialistëve të arsimit dhe drejtuesve për të monitoruar ose për të mbështetur mësimdhënien në këtë cikël shkollimi si edhe prindërve për qëllime informimi. Udhëzuesi i shërben:

- *Mësuesve* për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe të arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- *Specialistëve të arsimit* për të monitoruar dhe për të mbështetur shkollat.
- *Prindërve* për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe të kritereve të vlerësimit në periudha të caktuara.

# PLANI MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR

Plani mësimor është një dokument i rëndësishëm, i cili orienton shkollën për organizimin e procesit mësimor, në nivel shkolle, shkalle dhe klase.

Në planin mësimor përcaktohen:

- fushat e të nxënit dhe lëndët për secilën shkallë;
- shpërndarja e lëndëve përgjatë shkallëve;
- numri i orëve javore për secilën klasë.

Në tabelën 1 është pasqyruar vetëm plani mësimor i kurrikulës së re i arsimit fillor, i cili është pjesë e planit të arsimit bazë (klasat 1-9).

**Tabela 1. Plani mësimor i arsimit fillor**

Nr.	FUSHA/LËNDËT	KLASAT					GJITHSEJ
		Shkalla 1 <sup>1</sup>		Shkalla 2			
		I	II	III	IV	V	
<b>1</b>	<b>GJUHËT DHE KOMUNIKIMI</b>	<b>8</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>8</b>	<b>8</b>	<b>41</b>
1.1	Gjuhë shqipe	8	8	6	5	5	32
1.2	Gjuhë e huaj e parë	-	-	3	3	3	9
<b>2</b>	<b>MATEMATIKA</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>20</b>
<b>3</b>	<b>SHKENCAT E NATYRËS</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>7</b>
3.1	Dituri natyre	1	1	1	2	2	7
<b>4</b>	<b>SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>7</b>
4.1	Edukim për shoqërinë	1	1	-	-	-	2
4.2	Qytetari	i	i	1	1	1	3
4.3	Histori	i	i	-	1	1	2
<b>5</b>	<b>ARTET</b>	<b>2</b>	<b>2.5</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>2.5</b>	<b>12</b>
5.1	Muzikë	1	1	1	1	1	5
5.2	Art pamor	1	1	1	1	1	5
5.3	Kërcim	-	0.5	1	-	-	1.5
5.4	Teatër	-	-	-	-	0.5	0.5

<sup>1</sup>Shkalla I e kurrikulës përfshin dhe nis me vitin përgatitor, moshën 5-6 vjeç. Ky udhëzues është hartuar për të ndihmuar mësuesit e arsimit fillor në zbatimin e kurrikulës së re.

<b>6</b>	<b>EDUKIMI FIZIK, SPORTET DHE SHËNDETI</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>15</b>
<b>7</b>	<b>TEKNOLOGJIA DHE TIK-U</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>4</b>
7.1	TIK	-	-	-	1	1	2
7.2	Aftësim teknologjik praktik	-	-	-	1	1	2
<b>8</b>	<b>KURRIKULA ME ZGJEDHJE</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>8</b>

# ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËRMJET FUSHAVE TË TË NXËNIT

*Kompetenca* përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies. Organizimi i mësimit me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësiduhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën.

Kur nxënësi realizon kompetencat lëndore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyç. Ndërtimi dhe zhvillimi i kompetencave kyç nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të tënxënit.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës mësuesi ndjek hapat e mëposhtme:

- *përzgjedh rezultatin/et e të nxënit* nga kompetencat kyç që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse dhe e/ i zbërthen atë/ato;
- *përzgjedh rezultatin/et e të nxënit* për shkallë për kompetencat e lëndës që synon të arrijë nxënësi;
- *zbërthen në rezultate të nxëni* për kompetencat e lëndës për vit mësimor, rezultatin/et e të nxënit për shkallë;
- *përzgjedh* përmbajtjen mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizohen rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç në një vit mësimor;
- *planifikon mësimdhënien* duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- *kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve* pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të tënxënit për vit mësimor dhe shkallë për lëndët në ciklin fillor.

# KOMPETENCAT DHE TEMATIKAT E FUSHAVE TË TË NXËNIT

Në arsimin fillor zhvillohen **13 lëndë mësimore**, të përmbledhura në **7 fusha të nxëni**. Secila fushë ka kompetencat e saj. Përmbushja e rezultateve të tyre realizohet nëpërmjet përmbajtjes, e cila në disa lëndë jepet brenda kompetencave të fushës dhe në disa lëndë jepet sipas tematikave.

Programet mësimore të arsimit fillor kanë të njëjtën strukturë dhe rubrika për çdo lëndë. Në mënyrë të përmbledhur, në vijim jepen kompetencat, tematikat dhe numri i orëve për secilën klasë sipas lëndëve përkatëse. Numri i orëve për çdo lëndë mund të lëvizë nga njëri mësues te tjetri sepse ka fleksibilitet që 10% e orëve nga njëra tematikë të kalojë në tematikën tjetër.

## FUSHA: GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

Tabela 2. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Gjuhë shqipe

Kompetencat	Tematikat	Shpërndarja e orëve sipas klasave				
		I	II	III	IV	V
› Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullat e të dëgjuarit</li> <li>• Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të vlerësuar tekstin</li> </ul>	10	10	10	5	5
› Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullat dhe organizimi i të folurit</li> <li>• Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup</li> </ul>	10	10	10	5	5
› Të lexuarit e teksteve të	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lexuarit fillestar</li> </ul>	160	150	95	75	75

ndryshme	(klasa I-III)					
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lexuarit për të kuptuar</li> <li>• Të lexuarit e teksteve letrare</li> <li>• Të lexuarit e teksteve joletrare</li> </ul>					
›Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkrimi i dorës</li> <li>• Planifikimi, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit</li> <li>• Të shkruarit për qëllime personale</li> <li>• Të shkruarit për qëllime funksionale</li> </ul>	70	60	35	30	30
› Përdorimi i drejtë i gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sintaksë</li> <li>• Morfologji</li> <li>• Leksikologji dhe semantikë</li> <li>• Drejtshkrim</li> <li>• Fonetikë dhe fonologji</li> </ul>	30	50	60	60	60

**Tabela 3. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Gjuhë e huaj**

<b>Kompetencat</b>	<b>Tematikat</b>	<b>I</b>	<b>II</b>	<b>III</b>	<b>IV</b>	<b>V</b>
› Gjuhësore	• Formimi kulturor	-	-	42	42	42
	• Gramatika	-	-	32	32	32
›Socio-gjuhësore	• Funkcionet gjuhësore	-	-	21	21	21
›Pragmatike	• Portofoli evropian i gjuhëve	-	-	10	10	10

## FUSHA/ LËNDA: MATEMATIKË

Tabela 4. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Matematikë

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
› Zgjidhja e situatës problemore	• Numri	86	77	77	75	70
	• Matja	25	28	28	25	23
	• Gjeometria	13	24	24	24	22
› Arsyetimi dhe vërtetimi matematik	• Algjebra dhe funksioni	3	3	3	4	4
	• Statistika dhe probabiliteti	13	8	8	12	11
› Të menduarit dhe komunikimi matematik	<i>Orë përgatitje për provimin e klasës së pestë</i>	-	-	-	-	10
	› Lidhja konceptuale					
› Modelimi matematik						
› Përdorimi i teknologjisë në matematikë						

## FUSHA: SHKENCAT E NATYRËS

Tabela 5. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Dituri natyre

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
› Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre	• Diversiteti	17	5	7	5	-
	• Ciklet	5	-	-	5	37
	• Sistemet	-	11	20	28	10
	• Ndërveprimet	7	19	8	15	-
› Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore	• Energjia	6	-	-	17	23
› Komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës						



## FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI

**Tabela 6. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Edukim për shoqërinë (klasat 1-2), Qytetari (klasat 3-5)**

Kompetenca shoqërore dhe qytetare	Tematikat	I	II	III	IV	V
›Personale	• Individët, grupet, shoqëria	20	20	7	14	12
›Ndërpersonale	• Kultura	-	-	7	8	8
›Ndërkulturore	• Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi	7	7	7	7	9
	• Pushteti, autoriteti, qeverisja	8	8	14	6	6

**Tabela 7. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Histori**

Kompetencat historike	Tematika	Klasa IV	Orë	Klasa V	Orë
› Kërkimi historik	Proceset historike, koha,	• Historia ime dhe e familjes sime	11	• Historia dhe burime	11
›Përdorimi i burimeve	ndryshimi dhe vazhdimësia	• Lojërat, argëtimet, festat dhe festimet	6	• Shoqëritë e para njerëzore	12
›Analiza shkaktuese		• Mite dhe legjenda	4	• Qytetërimet antike, themeli i kulturës evropiane	12
›Interpretimi historik					
›Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën		• Zona dhe vendi im	14		

## FUSHA: ARTET

**Tabela 8. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Muzikë**

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
›Krijimi muzikor	• Gjuha dhe komunikimi muzikor	6	8	8	8	8
›Performimi/interpretimi muzikor	• Teknika dhe procese muzikore	24	22	22	22	22
›Vlerësimi i veprave muzikore	• Historia, muzika dhe shoqëria	5	5	5	5	5

**Tabela 9. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Art pamor**

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
›Krijimi artistik	• Gjuha dhe komunikimi artistik	10	10	10	10	10
›Performimi artistik	• Teknika dhe procese artistike	20	20	19	19	19
›Vlerësimi artistik	• Historia, arti dhe shoqëria	5	5	6	6	6

**Tabela 10. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Kërcim**

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
›Krijimi nëpërmjet lëvizjeve	• Gjuha dhe komunikimi i kërcimit	-	5	7	-	-
›Performimi/interpretimi i lëvizjeve dhe i kërcimit	• Teknika dhe procese të kërcimit	-	10	23	-	-
›Vlerësimi i lëvizjeve dhe i kërcimeve	• Historia, kërcimi dhe shoqëria	-	3	5	-	-

**Tabela 11. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Teatër**

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
›Krijimi i veprave teatrale	• Gjuha dhe komunikimi teatror	-	-	-	-	6
›Interpretimi i veprave teatrale	• Teknikat dhe proceset teatrale	-	-	-	-	8
›Vlerësimi i veprave teatrale	• Historia, teatri dhe shoqëria	-	-	-	-	4

## FUSHA: Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti

**Tabela 12. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Edukim fizik, sporte dhe shëndet**

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
›Zhvillimi i aftësive lëvizore në përshtatje me situata lëvizore e sportive të ndryshme	•Edukim nëpërmjet aktiviteteve fizike	45	45	45	40	40
	• Aktivitete sportive	35	35	35	45	45
›Ndërveprimi me të tjerët në situata të ndryshme lëvizore e sportive	•Praktikim aktiviteteve në shërbim të komunitetit, mirëqenies dhe shëndetit	25	25	25	20	20
›Përshtatshmëria me një stil jete aktiv e të shëndetshëm						

## FUSHA: TEKNOLOGJI DHE TIK

Tabela 13. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: TIK

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
› Kreativiteti dhe inovacioni	• Bota e kompjuterit	-	-	-	8	8
	• Përpunimi digjital i të dhënave	-	-	-	9	9
›Komunikimi dhe bashkëpunimi	• Kreativiteti dhe programimi	-	-	-	7	7
›Kërkimi dhe gjetja e informacionit	• Përpunimi digjital i të dhënave dhe prezantimit	-	-	-	7	7
›Mendimi kritik, problem-zgjidhja dhe vendimmarrja	• Siguria në internet dhe siguria e të punuarit në kompjuter	-	-	-	4	4
› Mbrojtja						

Tabela 14. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Aftësim teknologjik praktik

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
› Komunikimi grafik	• Tekstilet dhe mirëmbajtja	-	-	-	10	10
›Strukturat dhe materialet teknologjike	•Mirëmbajtja e mjedisit shtëpiak, e kopshtit	-	-	-	10	10
›Teknologjia dhe veprimtaria ekonomike	• Gatimi dhe ruajtja e ushqimeve	-	-	-	15	15
›Teknologjia, sistemet teknologjike dhe bota e kompjuterit						

# KURRIKULA ME ZGJEDHJE

Kurrikula me zgjedhje është pjesë e kurrikulës së përgjithshme, e cila në dallim nga kurrikula bërthamë zgjidhet nga shkolla dhe zhvillohet brenda kohës së planifikuar në planin mësimor, në përputhje me interesat, potencialet, mundësitë, informacionet paraprake të nxënësve dhe me mundësitë e shkollës.

Kurrikula me zgjedhje në shkallën e parë dhe të dytë, nga klasa I-V mund të përdoret:

- përveprimtarinë përmbushje të nevojave dhe të interesave të nxënësve, si dhe në funksion të përmbushjes së kompetencave kyç;
- për zgjerimin dhe thellimin e lëndëve të kurrikulës bërthamë;
- për hartimin e moduleve me bazë temash, nxitjen e të mësuarit me projekte dhe veprimtari të ndryshme nga kurrikula bërthamë dhe çështjet ndërkurrikulare.

Për kurrikulën me zgjedhje në arsimin fillor nxënësi nuk merr vlerësim në regjistër.

# PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES

Planifikimi është një proces i rëndësishëm i zbatimit të kurrikulës, i cili i krijon mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe fleksibël në procesin e mësimdhënies. Për një planifikim të mirë, mësuesi i arsimit fillor duhet të njohë dokumentet e mëposhtme:

- Kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar;
- Kurrikulën bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor;
- Programet mësimore lëndore që zhvillohen nga klasa e parë deri në klasën e pestë;
- Nivelet e arritjes së kompetencave të fushave të të nxënit në arsimin fillor.

Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja dhe zotërimi i kërkesave të programeve mësimore në nivel klase, shkalle dhe cikli.

## Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimdhënies përfshin:

- planifikimin vjetor të lëndës;
- planifikimin e tri periudhave;
- planifikimin ditor.

Në fillim të vitit shkollor, mësuesi dorëzon pranë drejtorisë së shkollës *planifikimin vjetor të lëndës*, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe *planifikimin e periudhës së parë*. Planifikimet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës prej tyre.

Gjatë vitit shkollor, sipas rrethanave që i krijohen, në planifikimet e dorëzuara mund të bëhen ndryshime, sepse mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse.

## Planifikimi vjetor i lëndës

Për realizimin e planifikimit vjetor të lëndës, mësuesi, përveç programit mësues, duhet të studiojë edhe tekstin shkollor që ka përzgjedhur të punojë. Realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti i përzgjedhur shkollor është një prej mjeteve që e ndihmojnë për të përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi eidenton që tekstit të përzgjedhur i mungon një njohuri, koncept a tematikë nga programi ose nuk përmbush një rezultat të nxëni, atëherë mësuesi gjen dhe përdor burime të tjera të nxëni.

Planifikimi vjetor është një plan sintetik. Mësuesi e planifikon shpërndarjen e orëve dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tri periudha, me qëllim krijimin e idesë për shtrirjen dhe realizimin e saj (të përmbajtjes) në secilën prej tyre.

**Tabela 15. Formati i planifikimit mësues vjetor**

Kompetencat/ Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes lëndore sipas kompetencave/ tematikave		
	Periudha e parë	Periudha e dytë	Periudha e tretë

Në kolonën “*Kompetencat/ Tematikat*” shkruhen emërtimet e tematikave/kompetencave që ka lënda dhe orët e tyre përkatëse.

Në kolonën “*Shpërndarja e përmbajtjes lëndore*” vendoset përmbajtja e lëndës që do të trajtohet në secilën periudhë dhe sasia e orëve në të cilën do të zhvillohen. Gjithashtu, vendoset edhe totali i orëve për secilën periudhë, ku përfshihen njohuri, projekte, përsëritje, dikttime, ekskursione mësimore, teste etj., që parashikon të zhvillojë mësuesi në secilën periudhë.

## Planifikimi i tri periudhave

Planifikimi i periudhës është një planifikim më afatshkurtër dhe më i detajuar i mësimdhënies. Ky lloj planifikimi kërkon që mësuesi të përcaktojë me kujdes përmbajtjet mësimore që do të zhvillojë gjatë kësaj periudhe, orët mësimore brenda të cilave ato do të realizohen, duke planifikuar paraprakisht situatat e të nxënit përmes të cilave do të mundësohet zhvillimi i kompetencave, burimet e të nxënit, metodologjitë e mësimdhënies si dhe llojet e vlerësimit dhe instrumentet vlerësuese.

Plani i një periudhe është analitik dhe në të detajohen temat mësimore që do të zhvillohen përgjatë saj. Mësuesi harton planin e periudhës përkatëse në fillim të saj dhe e dorëzon në drejtorinë e shkollës para fillimit të periudhës. Ky plan hartohet duke iu përmbajtur programit dhe tekstit mësimor përkatës. Në planet sipas periudhave planifikohen të gjitha orët. Mësuesit janë të lirë të bëjnë ndryshimet e tyre hap pas hapi në varësi të specifikave të lëndës së tyre. Nëse gjatë zbatimit të planit ndjen nevojën e ndryshimit, mësuesi i bën duke njoftuar dhe ndryshuar planifikimin e dorëzuar në drejtorinë e shkollës.

### Formati i planifikimit të një periudhe

Në vijim jepet *formati orientues* i planifikimit të periudhës.

Tabela 16. Format i planifikimit të periudhës

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç dhe kompetencave të fushës/ lëndës						
Nr.	Kompetencat/ Tematikat	Temat mësimore	Situatate të nxënit	Metodologjitë dheveprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet/ materialet dhe mjetet didaktike
1.						
...						



Në rubrikën “Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç dhe kompetencave të fushës/ lëndës” vendosen rezultate specifike që realizohen përgjatë temave mësimore në secilën periudhë. Pra mësuesi, duke njohur përmbajtjen e temave dhe të veprimtarive mësimore përcakton rezultatet e kompetencave kyç dhe të fushës/ lëndës që përmbushen në to.

Në kolonën “Numri” renditen të gjitha orët mësimore që do të realizohen nga mësuesi gjatë një periudhe. P.sh., Matematika zhvillohet në 140 orë. Në këtë kolonë do të shënohen ± rreth 46 orë. E njëjta logjikë ndiqet për të gjitha lëndët.

Në kolonën “Kompetencat/ Tematikat” vendosen kompetencat ose tematikat për të cilat jepen orët në secilin program lëndor. Kjo kolonë përkon me kolonat e tri periudhave të planifikimit vjetor. P.sh., për lëndën e gjuhës shqipe do të vendosen kompetencat, sepse orët mësimore të programit janë shpërndarë në 5 kompetencat që ka kjo lëndë. Në lëndën e diturisë së natyrës do të vendosen tematikat, sepse orët mësimore të programit janë shpërndarë në 5 tematikat që ka kjo lëndë. E njëjta logjikë ndiqet për të gjitha lëndët.

Në kolonën “Temat mësimore” shënohen të gjitha temat mësimore që do të zhvillohen gjatë periudhës. Pra, mësuesi shënon si temat që i korrespondojnë tekstit shkollor, ashtu edhe përsëritjet, diktimet, testet, analizat e rezultateve, konkurset, leximet jashtëklase, projektet, ekskursionet, veprimtaritë praktike, vizitat mësimore, demonstrime e prezantime të ndryshme, shfaqje artistike, teatrale, ekspozita etj.

Në kolonën “Situatat e të nxënit” vendosen situatat e të nxënit që mësuesi parashikon të realizojë gjatë periudhës, të cilat mund të ndryshohen dhe plotësohen përgjatë zhvillimit të lëndës. Situatat e të nxënit mund t’i përkasin një teme mësimore, disa temave mësimore, ashtu sikurse mund të ketë tema mësimore për të cilat mësuesi nuk mund të zhvillojë situata të nxëni. P.sh., nëse në lëndën e gjuhës shqipe, klasa e parë, nxënësit do të mësojnë shkronjën D, atëherë situata e të nxënit mund të lidhet me fjalët *Dentisti* ose *Ditëlindja*. Për krijimin e situatës së të nxënit mësuesi mund të shfrytëzojë një ditëlindje apo një mjedis ku festohet ajo ose mund të shfrytëzojë mjedis në të cilin punon një dentist etj. Nëse në artin pamor, për të përfituar përvoja artistike, programi kërkon që nxënësi të zbulojë profesione të ndryshme në lidhje me

artin pamor si: artistë, artizanë, arkitektë, mësues arti, dizajnë etj., atëherë tema mësimore mund të zhvillohet në studion e një artisti, në punishtet e një artizani, në një studio grafike etj., me të cilët është biseduar paraprakisht. Pra situata e të nxënësve është një situatë praktike ose reale në të cilën nxënësi përmbush një ose disa rezultate të nxënësve.

Në kolonën “*Metodologjitë dhe veprimtaritë e nxënësve*” shënohen metodat, teknikat dhe format e ndryshme të organizimit të punës me nxënësit që mësuesi parashikon t’i zhvillojë në temat mësimore të periudhës. Plotësime dhe detajime në këtë rubrikë bëhen gjatë zhvillimit të temave mësimore.

Në kolonën “*Vlerësimi*” shënohen teknikat dhe instrumentet e vlerësimit që do të përdoren për vlerësimin e nxënësit përgjatë periudhës. Për plotësimin e kësaj rubrike mësuesi do t’i referohet rubrikës “Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës/ lëndës”, të cilat nxënësi do të demonstrojë në mënyra të ndryshme (sa dhe si i ka përmbushur). Gjithashtu, në këtë kolonë, mësuesi mund të shënojë edhe teknikat e vlerësimit që parashikon të përdorë.

Kolonën “*Burimet/ materialet dhe mjetet didaktike*” mësuesi e plotëson për tema të caktuara mësimore, ku përveç tekstit shkollor ai parashikon të përdoren burime të tjera, CD, site interneti, materiale dhe mjete didaktike.

## Planifikimi ditor

Në përditshmërinë e tij mësuesi i arsimit fillor bën planifikimin ditor për të gjitha lëndët që do të zhvillojë sipas orarit javor që ka plotësuar në regjistrin e klasës.

Në rubrikën “*Lënda*” shënohet emërtimi i lëndës.

Në rubrikën “*Tema/t mësimore*” shënohet tema e mësimit për një orë të caktuar mësimore. Në rastin kur gjatë një dite, mësuesi ka për të zhvilluar dy orë nga e njëjta lëndë, atëherë shënohet/n tema/t dhe shtjellimi bëhet për të dyja orët së bashku, pra për 90 minuta. Në rastin kur mësuesi zhvillon një ditë të integruar mësimore, atëherë ai shënon që në fillim të gjitha temat mësimore sipas lëndëve.

Rubrika “*Situata e të nxënit*” plotësohet në rast se mësuesi ka parashikuar për atë temë mësimi një situatë të tillë. Në rast se nuk ka, atëherë kjo rubrikë nuk shënohet fare.

Në vijim jepet *formati orientues* i planit ditor.

**Tabela 17. Planifikimi ditor**

Data __/__/_____	
<b>Lënda:</b>	
<b>Tema/t mësimore</b>	<b>Situata e të nxënit</b>
<b>Rezultatet e të nxënit</b>	<b>Konceptet/ Fjalët kyç</b>
<b>Nxënësi:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪</li> <li>▪ ...</li> </ul>	
<b>Burimet, materialet dhe mjetet didaktike</b>	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare</b>
<b>Ecuria e zhvillimit të mësimi</b>	
(Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)	
<b>Vlerësimi</b>	
<b>Detyra</b>	

Rubrika “*Rezultatet e të nxënit*” që mësuesi shënon për një temë të caktuar mësimore, rrjedh nga rubrika “*Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/ lëndës*”, të përcaktuara në planifikimin sipas periudhave. Ato duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme dhe të kuptueshme për atë që pritet të demonstron nga nxënësi.

Në rastin kur mësuesi zhvillon një ditë të integruar mësimore, atëherë ai shënon në grup të gjitha rezultatet e të nxënit për të cilat do të punohet gjatë gjithë ditës.

Për hartimin e rezultateve të të nxënit, *mësuesi i referohet foljeve përshkruese të Taksonomisë së Blumit*, të cilat në mënyrë të përmbledhur i gjen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 18. Taksonomia e Blumit

Nivelet e të menduarit	Foljet përshkruese për rezultatet e të nxënit
<p><b>1. Njohja</b></p> <p>Është riprodhimi i një diçkaje pa shpjegime dhe pa e lidhur me gjë tjetër. Përsëritje e emrave, e rregullave, e përkufizimeve dhe e shpjegimeve ashtu siç është dhënë. Është niveli më i ulët i rezultateve të nxënësve në fushën e njohjes.</p>	<p>Përkufizo, përsërit, përshkruaj me fjalët e tekstit, identifiko, vër në tabelë, harto një listë, emërto, riprodho etj.</p>
<p><b>2. Të kuptuarit</b></p> <p>Është aftësia për të kapur kuptimin e materialit. Është baza e fushës së njohjes, një hap më tej se të njohurit.</p>	<p>Shpjego, zgjero, jep shembuj të tjerë, nxirr përfundime, perifrazo, rishkruaj, përgjithëso, interpreto ndryshe, nxirr një përfundim etj.</p>
<p><b>3. Zbatimi:</b></p> <p>Është aftësia për të përdorur materialin e mësuar në situata të reja dhe konkrete. Zbatohen rregulla, metoda, koncepte, parime, ligje dhe teori.</p>	<p>Zbato, shfrytëzo, ndrysho, njehso, klasifiko, provosh, vër në dukje, manipululo, përgatit, lidh, trego, shpjego, përdor etj.</p>
<p><b>4. Analiza:</b></p> <p>Është aftësia për ta copëtuar materialin në pjesë përbërëse, ç'ka sjell një kuptim më të mirë të organizimit të tij. Meqenëse krahas përmbajtjes kuptohet edhe forma organizative e materialit, niveli intelektual është më i lartë se në të kuptuarit</p>	<p>Copëto, ndaj në pjesë, shpjego përse, diferenco, shquaj, dallo, vër në dukje, lidh, seleksiono etj</p>
<p><b>5. Sinteza:</b></p> <p>Është aftësia që formon një të tërë duke bashkuar pjesët. Mund të jetë: komunikim i një plani veprimesh, klasifikim informacioni etj.</p>	<p>Kombino, harto, krijo, zgjidh (një problem që ka shumë rrugë), kompoz, jep mendime, përmirëso, organizo, shkruaj, planifiko, trego, risistemo, prodho, harto, transmeto, krijo, propoz, planifiko, prodho, modifiko, specifiko, kombino, organizo, sintetizo, klasifiko, përfundo, zhvillo, modifiko, ndërto etj.</p>
<p><b>6. Vlerësimi:</b></p> <p>Është aftësia për të gjykuar vlerën e një materiali, të mirën e një ideje, motivet e sjelljeve, vlerësimin e zgjidhjeve të problemit, ndërtimi i komunikimeve gjykuese etj.</p>	<p>Krahaso, nxirr një përfundim, vër në kontrast, kritiko, përshkruaj, shpjego, justifiko, interpreto lidh, përmblihdh, bëj një evidencë etj.</p>

Në rubrikën “*Konceptet/ fjalët kyç*” do të shënohen konceptet apo termat kryesore që do të trajtohen gjatë temës së mësimimit.

Në rastin kur mësuesi zhvillon një ditë të integruar mësimore, atëherë ai i shënon në grup të gjitha konceptet kryesore që do të trajtohen gjatë ditës.

Në rubrikën “*Burimet, materialet dhe mjetet didaktike*” mësuesi shënon burime dhe materiale specifike që duhen për atë orë mësimi dhe që janë të rëndësishme e të vlefshme për t’u shfrytëzuar.

Rubrika “*Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare*” është një rubrikë shumë e rëndësishme e planifikimit ditor. Për mësuesin e ciklit fillor, i cili e jep vetë pjesën më të madhe të lëndëve të një klase, kjo rubrikë do të jetë e shkrirë si te rubrika “*Tema/t mësimore*”, edhe te “*Ecuria e zhvillimit të mësimimit*”. Në rast se një temë e caktuar mësimi nuk ka lidhje me fushat e tjera apo me temat ndërkurrikulare, atëherë ajo rubrikë nuk shënohet fare.

Në rubrikën “*Ecuria e zhvillimit të mësimimit*”, mësuesi shënon hap pas hapi të gjitha veprimtaritë që do të kryejë:

- brenda një ore mësimi;
- brenda dy orëve mësimi të njëpasnjëshme nga e njëjta lëndë;
- brenda një dite të integruar.

Gjithashtu në këtë rubrikë, mësuesi shënon veprimtaritë dhe metodat që do të përdoren prej tij dhe nga nxënësit.

Në rubrikën “*Vlerësimi*” mësuesi shënon për çfarëdo t’i vlerësojë nxënësit apo do të mbajë shënime vlerësuese. Vlerësimi bazohet në nivelet e arritjeve të përshtatura për konceptet e zhvilluara në tema të ndryshme mësimore. Në kurrikulën e re, mësuesi përpiqet që gjatë gjithë kohës t’i vendosë të gjithë nxënësit në veprimtari praktike dhe në situata të tilla që ata të veprojnë, me qëllim përmbushjen e rezultateve të të nxënimit. Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi ndjek performancën e secilit prej tyre dhe mban shënime vlerësuese për ta. Pra, mësuesi plotëson:

Nxënësi vlerësohet për: (shkruhen pritshmëritë për përmbushjen e rezultateve të të nxënësit)

- ...
- ...

Vlerësimi do të bazohet në përshkallëzimin e përmbushjes së rezultatit sipas niveleve të arritjeve të përshtatura për konceptet e zhvilluara në temat mësimore:

Niveli 2:

Niveli 3:

Niveli 4:

Niveli 5<sup>2</sup>:

Në rubrikën “Detyrat e shtëpisë” shënohen ushtrimet, kërkesat, temat, titujt e detyrave që do t’u jepen nxënësve për të punuar në shtëpi. Detyrat mund të jenë individuale ose në grup.

## Planifikimi i kurrikulës me zgjedhje

Planifikimi i kurrikulës me zgjedhje bëhet sipas tri periudhave të vitit, njësoj si planifikimi për çdo lëndë të arsimit fillor. Rubrikat e planifikimit të kurrikulës me zgjedhje janë:

**Tabela 19. Planifikimi i kurrikulës me zgjedhje**

Rezultatet e të nxënësit			
▪ ...			
Nr.	Temat/ Veprimtaritë	Kohëzgjatja/ Nr. i orëve	Materialet mësimore, burimet dhemjetetndihmëse
1.			
2.			
...			

<sup>2</sup>Niveli 5 vlen për vlerësimin e nxënësit në klasat I-III.

**Tabela 20. Planifikimi ditor i kurrikulës me zgjedhje**

<b>Data</b> __/__/_____
Tema/ Veprimtaria
Rezultatet e të nxënit
Burimet, materialet dhe mjetet didaktike
Udhëzimet metodike për realizimin e saj
Veprimtaria 1
Veprimtaria 2
...
Detyra (nëse ka)

# VLERËSIMI I NXËNËSIT NË ARSIMIN FILLOR

Vlerësimi i nxënësve është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencat. Ky vlerësim, bazuar në rezultatet e të nxënësve, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësve (njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjeve.

Gjatë viteve të para të shkollës, kujdes i veçantë i kushtohet zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe qëndrimit pozitiv ndaj të nxënësve, si bazë për zhvillimin e kompetencës kyç “Të mësuarit për të nxënësve”.

Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilat përcaktohen si të domosdoshme për të vlerësuar arritjet dhe zhvillimin individual, për të evidentuar anët dhe pikat e forta, si dhe drejtimet të cilat çdo nxënës ka nevojë për ndihmë, mbështetje dhe motivim.

Vlerësimi realizohet nëpërmjet përdorimit të instrumenteve dhe të procedurave të ndryshme të mbledhjes së të dhënave, interpretimit dhe analizës së tyre në dobi të përmirësimit të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Njohja më e mirë e nxënësve dhe e arritjeve të tyre e ndihmon mësuesin dhe prindin të punojnë më tepër në ato drejtime, të cilat pengojnë ecurinë dhe përparimin e tyre të mëtejshëm. Kohë pas kohe, gjykimin për atë çfarë arrin nxënësi, sinjalizon të rriturin si po lëviz trajektorja e progresit të tyre.

## Vlerësimi i nxënësve në klasat I-III

Vlerësimi i nxënësve në klasat I-III bëhet me përshkrim. Përshkrimi i vlerësimit ka si qëllim evidentimin e anëve të forta, të dobësive dhe vështirësive konkrete që ka nxënësi në çdo program lëndor. Mbajtja e shënimeve për ecurinë dhe përparimin e nxënësve siguron informacione të dobishme për mësuesin dhe e ndihmon në rishikimin e përmbajtjes mësimore në ato raste kur të nxënësve nuk është në rezultatet e pritshme.



Vlerësimi i nxënësit për arritjen e kompetencave të fushave të të nxënës realizohet në përfundim të secilës periudhë. Ai bazohet në shënimet vlerësuese të mësuesit që lidhen me vlerësimin e vazhduar, në vlerësimin e punimeve dhe të produkteve individuale të nxënësit që tregojnë interesin për të nxënë, si dhe në vlerësimin e testeve ose të detyrave përmbledhëse.

Në fund të çdo periudhe për të bërë vlerësimin përshkrues të nxënësit, mësuesi mban parasysh raportet mes tri llojeve të vlerësimit:

- ***Përgatitja dhe performanca sistematike e nxënësit*** (Vlerësimi i vazhduar) përbën 45% të vlerësimit. Ky vlerësim ndahet 15% për përgatitjen e nxënësit dhe detyrat që ai bën në shtëpi; 30% për punët e detyrat me shkrim që kryen nxënësi në klasë dhe përgjigjet që jep me gojë.
- ***Punimet krijuese dhe nismat individuale, produktet dhe detyrat specifike që nxënësi bën në grup***, projektet dhe veprimtari të tjera që zhvillohen në klasë përbën 25% të vlerësimit.
- ***Diktimet, testimet dhe detyrat përmbledhëse*** përbëjnë 30% të vlerësimit. Ato dëshmojnë qëndrueshmërinë e rezultateve të të nxënës të nxënësit.

Pra, për të bërë vlerësimin e nxënësit në fund të çdo periudhe, mësuesi do të mbajë parasysh sa përgatitjen sistematike të nxënësit, aq edhe qëndrueshmërinë e njohurive dhe të aftësive të fituara. Sigurisht që për nxënësin do të merret në konsideratë përgatitja që bën në shtëpi dhe interesin që shfaq për të nxënë.

Në klasat I-III të arsimit fillor, vlerësimi i nxënësit në regjistër bëhet për secilën kompetencë që ka çdonjëra nga fushat e të nxënës/ lëndët. Pra, si për vlerësimin në fund të çdo periudhe, ashtu edhe për vlerësimin përfundimtar në fund të vitit shkollor, nxënësi do të marrë vlerësime për secilën kompetencë. Kjo do të thotë që:

- për lëndën e gjuhës shqipe nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme; Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar; Të lexuarit e teksteve të ndryshme; Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale; Përdorimi i drejtë i gjuhës.*
- për lëndën e matematikës nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Zgjidhja e situatave të thjeshta problemore; Arsytimi dhe vërtetimi matematik; Të*

*menduarit dhe komunikimi matematik; Lidhja konceptuale; Modelimi matematik; Përdorimi i teknologjisë në matematikë.*

- për lëndën e diturisë së natyrës nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre; Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore; Komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës.*
- për lëndën e edukimit për shoqërinë/ qytetarinë nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencën *shoqërore dhe qytetare.*
- për lëndën e historisë nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Kërkimi historik; Përdorimi i burimeve; Analiza shkak-pasojë; Interpretimi historik; Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.*
- për lëndën e muzikës nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Krijimi muzikor; Performimi/ interpretimi muzikor; Vlerësimi i veprave muzikore.*
- për lëndën e artit pamor nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Krijimi artistik; Performimi artistik; Vlerësimi artistik.*
- për lëndën e kërcimit nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Krijimi nëpërmjet lëvizjeve; Performimi/ interpretimi i lëvizjeve dhe i kërcimit; Vlerësimi i lëvizjeve dhe i kërcimeve.*
- për lëndën e edukimit fizik, sportet dhe shëndeti nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Zhvillimi i aftësive lëvizore në përshtatje me situata lëvizore e sportive të ndryshme; Ndërveprimi me të tjerët në situata të ndryshme lëvizore e sportive; Përshtatshmëria me një stil jete aktiv e të shëndetshëm.*

Vlerësimi vjetor lëndor i nxënësit bëhet duke pasur parasysh vlerësimin përmblendhës (përfundimtar) të nxënësit sipas kompetencave të fushës/ lëndës.

Vlerësimi i nxënësit në klasat I-III realizohet me *5 nivelet e arritjes së kompetencave* si më poshtë:

- *Niveli 1. “Arritje të pakënaqshme”,* kur nxënësi nuk përmbush kërkesat bazë të të nxënës. Nxënësi që paraqet arritje të pakënaqshme plotëson pak detyra; ka nevojë të kujtohet shpesh për të bërë detyrat dhe është rrallë herë i motivuar; detyrat i mungojnë, janë të paplotësuara, të pasakta dhe mund t'i dorëzojë me vonësë; rrallë dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutimet në klasë dhe bashkëpunon me nxënësit e tjerë.

- *Niveli 2. “Arritje që kanë nevojë për përmirësim”,* kur nxënësi ka arritur vetëm pak nga kërkesat bazë të të nxënësve dhe kërkohet mbështetje dhe punë e vazhdueshme nga ana e tij dhe e mësuesit. Nxënësi që paraqet arritje që kanë nevojë për përmirësim është i motivuar për të plotësuar detyrat, megjithatë disa prej tyre mund të mos i zhvillojë plotësisht; herë pas here duhet kujtuar që të bëjë detyrat; ndonjëherë dëgjon me vëmendje dhe merr pjesë në aktivitete dhe diskutime në klasë dhe punon bashkërisht në grupe.
- *Niveli 3. “Arritje të kënaqshme”,* kur nxënësi ka përmbushur kërkesat bazë të të nxënësve dhe, kur me mbështetjen e mësuesit, arrin të përparojë. Nxënësi që paraqet arritje të kënaqshme zakonisht është i motivuar dhe i përqendruar në detyra; i plotëson detyrat në kohë; zakonisht dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutim dhe në aktivitetet e klasës dhe bashkëpunon në grup.
- *Niveli 4. “Arritje shumë të kënaqshme”,* kur nxënësi ka përmbushur pjesën më të madhe të kërkesave të të nxënësve. Nxënësi që paraqet arritje shumë të kënaqshme është i vetë-motivuar; i plotëson detyrat me kënaqësi; shpesh kërkon dhe vihet përpara sfidave; thajse gjithmonë dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutim dhe në aktivitetet e klasës dhe punon bashkërisht në grupe.
- *Niveli 5. “Arritje të shkëlqyera”,* kur nxënësi përmbush plotësisht dhe me cilësi kërkesat e të nxënësve të programit lëndor. Nxënësi që paraqet arritje të shkëlqyera është i vëmendshëm; është i vetëdrejtuar; kërkon sfida; plotëson detyrat me entuziazëm; ndërmerri iniciativa; merr pjesë me entuziazëm në diskutim dhe në aktivitetet e klasës; kontribuon në ndërveprimin efektiv të grupeve bashkëvepruese; merr përgjegjësi për të zgjeruar rritjen personale dhe akademike.

## Vlerësimi i nxënësit në klasat IV dhe V

Dokumenti “Nivelet e arritjes së kompetencave të fushave të të nxënësve” për shkallën 1 dhe 2 të kurrikulës, shpreh kritere të njësuara për vlerësimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të nxënësve sipas fushave përkatëse në nivel kombëtar **referuar ndaj një kriteri të përcaktuar**. Nivelet përcaktojnë arritjen e kompetencës nga nxënësi në fund të çdo viti shkollor, sipas shkallëve përkatëse.

Ky sistem vlerësimi zbatohet për arsimin bazë dhe të mesëm. Në këtë sistem, zbatohet vlerësimi me notë: nga nota 4 (pakaluese) në notën 10 si nota më e lartë. Nga klasa e katërt deri në klasën e dymbëdhjetë, janë përcaktuar **katër nivele arritjeje**<sup>3</sup>të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që demonstroi nxënësi:

- Niveli I (*pamjaftueshëm, nota 4*), kur nxënësi nuk përmbush kërkesat bazë të të nxënësit.
- Niveli II (*mjaftueshëm, notat 5-6*), kur nxënësi ka arritur disa nga kërkesat bazë të të nxënësit dhe kërkohet mbështetje dhe punë e vazhdueshme nga ana e tij për të përparuar.
- Niveli III (*mirë, notat 7-8*), kur nxënësi ka përmbushur një pjesë të konsiderueshme të kërkesave bazë të të nxënësit dhe, kur me mbështetjen e mësuesit, vazhdon të përparojë.
- Niveli IV (*shumë mirë, notat 9-10*), kur nxënësi përmbush plotësisht dhe me cilësi kërkesat e të nxënësit të programit lëndor.

**Për këtë arsye, vlerësimi në klasat IV dhe V do të shërbejë si pikë lidhje ndërmjet vlerësimit përshkrues në klasat I-III dhe vlerësimit me notë në klasat e tjera të sistemit arsimor parauniversitar.**

## Vlerësimi periodik i nxënësit

Në klasat IV dhe V, vlerësimi i nxënësit bëhet me notë. Duke iu referuar udhëzimit të MAS-it nr. 34, datë 11.09.2018, “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”, vlerësimi periodik i nxënësit për çdo lëndë bëhet në përfundim të secilës periudhë dhe përmban tri nota, të cilat vendosen në regjistër në kolonat përkatëse të faqet e vlerësimit:

- *Nota e vlerësimit të vazhdueshëm (NVv);*

---

<sup>3</sup>Në klasat IV-V janë përcaktuar **katër nivele arritjeje**, pasi në këtë grup-moshë fillon të rritet pesha e njohurive dhe e formimit akademik në vlerësimin e nxënësit dhe vlerësimi nuk bazohet më në **kriterin e normës**.

- *Nota e vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse<sup>4</sup> (NTp);*
- *Nota e vlerësimit të portofolit<sup>5</sup> të nxënësit (NVp).*

**Tabela 21. Vlerësimi periodik i nxënësit**

Periudha e parë			Periudha e dytë			Periudha e tretë		
NVv	NTp	NVp	NVv	NTp	NVp	NVv	NTp	NVp

## Vlerësimi përfundimtar i nxënësit

Vlerësimi përfundimtar për secilën lëndë shënohet në regjistër duke plotësuar kolonat “Vlerësimi vjetor” dhe “Nota përfundimtare”.

**Vlerësimi vjetor** përmban:

- *Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar (që bazohet në përparimin vjetor të nxënësit).*
- *Notën vjetore të vlerësimit me test ose detyrë përmbledhëse (që bazohet në përgatitjen dhe qëndrueshmërinë vjetore të njohurive dhe të shkathtësive të nxënësit).*
- *Notën vjetore të vlerësimit të portofolit të nxënësit (që bazohet në përpjekjet sistematike të nxënësit për të treguar interesin e tij për të nxënë, për të krijuar dhe për t’u përfshirë në nisma e veprimtari individuale ose në grup).*

**Në rastet kur ecuria e nxënësit është e dukshme progresive ose regressive gjatë periudhës së dytë dhe të tretë të vitit, vlerësimi vjetor në secilën nga rubrikat mund të jetë progresiv ose regresiv.**

<sup>4</sup>Duke u nisur nga specifikat e lëndëve që zhvillohen në arsimin fillor, mësuesi përcakton nëse në fund të secilës periudhë do të bëjë test për matjen e rezultateve kryesore të të nxënësve; do t’u kërkojë nxënësve të punojnë dhe të prezantojnë një temë të caktuar apo një detyrë përmbledhëse; të prezantojnë një projekt; të realizojnë një punim për në ekspozitë; të përgatiten për një interpretim në një shfaqje artistike, teatrale etj.

<sup>5</sup> Specifikat e portofolit të nxënësit në arsimin fillor janë dhënë **te kapitulli “Portofoli i nxënësit”**. Për vlerësimin e nxënësit për rubrikën “Vlerësimi i portofolit të nxënësit”, mësuesi duhet t’i referohet punimeve tematike, projekteve, punimeve individuale që bën nxënësi për çdo lëndë, sipas sugjerimeve të dhëna nga mësuesi, por edhe nismave vetjake që merr.

**Tabela 22. Vlerësimi vjetor i nxënësit**

Periudha e parë			Periudha e dytë			Periudha e tretë			Vlerësimi vjetor		
NV <sub>v</sub>	NT <sub>p</sub>	NV <sub>p</sub>	NV <sub>v</sub>	NT <sub>p</sub>	NV <sub>p</sub>	NV <sub>v</sub>	NT <sub>p</sub>	NV <sub>p</sub>	NV <sub>v</sub>	NT <sub>p</sub>	NV <sub>p</sub>

## Nota përfundimtare dhe vlerësimi vjetor

Nxjerrja e notës përfundimtare të nxënësit bëhet nëpërmjet hapave të mëposhtëm:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NV<sub>v</sub>).
- Përcaktohet nota vjetore e testit/ e detyrës përmbljedhëse (NT<sub>p</sub>).
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NV<sub>p</sub>).
- Shumëzohet secila prej notave me koeficientin e peshave për secilin lloj vlerësimi.

**Tabela 23. Përlogaritja e notës përfundimtare në klasat 4-5**

Lloji i vlerësimit	Pesha në përqindje
Vlerësimi i vazhdueshëm	45%
Vlerësimi me test ose detyrë përmbljedhëse	30%
Vlerësimi i portofolit të nxënësit	25%

- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rumbullakoset me numër të plotë.

Pra, formula që do të shërbejë për nxjerrjen e notës përfundimtare për secilën lëndë është:

$$(NV_v \times 0.45) + (NT_p \times 0.3) + (NV_p \times 0.25) = \text{Nota përfundimtare}$$

# SHËNIMET VLERËSUESE TË MËSUESIT

Vlerësimi përshkrues në arsimin fillor është specifik dhe i bazuar në karakteristikat e zhvillimit moshor dhe psikologjik të fëmijëve 6-11 vjeç sipas grup-moshave (6-9 vjeç dhe 10-11 vjeç). Ky vlerësim bazohet në analizën e plotë dhe të kujdesshme të punimeve me shkrim, në përfshirjen dhe pjesëmarrjen e nxënësit në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në shkollë. Nxënësi vlerësohet edhe për përgjigjet me gojë. Në këto përgjigje, nxënësi vlerësohet për mënyrën si shprehet, për qartësinë dhe saktësinë e prezantimit, për saktësinë e përgjigjeve ndaj pyetjeve që i bëhen, për nivelin e interpretimit dhe të arsyetimit, për besimin te vetja etj. Siç e kemi përmendur edhe më lart, vlerësimi i nxënësit është një proces shumë i rëndësishëm, i cili ndikon në motivimin dhe nxitjen e tij për të përmirësuar performancën dhe rezultatet individuale.

Mësuesi i arsimit fillor i zhvillon vetë të gjitha lëndët mësimore. Kjo është arsyeja që mësuesi i këtij cikli e njeh shumë mirë çdo nxënës të klasës në të gjitha aspektet: akademike, personale dhe sociale. Gjithashtu, kontaktet e mësuesit me prindërit ose pjesëtarët e tjerë të familjes janë të përditshme. Prezantimi i arritjeve dhe i dobësive ditore të nxënësve po ashtu.

Me zbatimin e kurrikulës së re ka ndryshuar edhe koncepti i vlerësimit të nxënësit. Në vëmendjen e mësuesit është përmbushja e rezultateve të nxënësit të çdo periudhe, të përkthyer këto në rezultate të nxënësve sipas temave mësimore në çdo lëndë.

Mësuesi nuk bën më parashikime se cilët dhe sa nxënës do të ketë në vëmendjen e tij për t'i vlerësuar gjatë një ore apo dite mësimore. Ai i mban parasysh dhe i mban të përfshirë të gjithë nxënësit, i pyet, i aktivizon, i vëzhgon dhe i ndjek nga njëra orë në tjetrën dhe nga njëra ditë në tjetrën.

Mësuesi mban shënime vlerësuese në lidhje me ecurinë dhe përparimin e vijueshëm të nxënësit, në mënyrë që vlerësimet që merr nxënësi të jenë objektive dhe të sakta. Përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, punët individuale, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimi i nxënësit, vlerësimi i nxënësit nga nxënësi,

pjesëmarrjet në aktivitete dhe diskutimet në klasë, detyrat e shtëpisë apo të klasës etj., vlerësohen meshprehje vlerësuese, simbole, kodeetj., që kanë lidhje me performancën apo arritjet e nxënësit në një temë mësimi, koncept, aftësi apo rezultat të nxëni. Sugjerohet që mësuesi të përcaktojë *një legjendë* në të cilën shpjegon kuptimin e simboleve të vendosura. Në klasat I-IV, nota në fletoren personale (evidencë) mund të vendoset në raste specifike, siç janë testet e ndërmjetme apo punët me shkrim, por edhe në tema të caktuara mësimi kur mësuesi e shikon të arsyeshme.

“Fletorja personale” dhe “evidenca” nënkuptojnë **të njëjtin dokument**. Pra, mësuesi ka vetëm një dokument për vlerësimin e vazhduar (vlerësimin për të nxënë). Mësuesi mban shënime në fletoren e tij personale (apo në evidencë), ecurinë e progresit të nxënësit lidhur me rezultatet e arritjes. Fletoren personale (evidencën), mësuesi **e formaton në mënyrën më të përshtatshme për të**, por duke ruajtur logjikën e vlerësimit për të nxënë. Me fletoren personale (evidencën) mësuesi është i lehtësuar nga ngarkesa ose nga presioni për të vënë nota në regjistër në mënyrë të vazhduar. Vendosja e notës në mënyrë të vazhduar gjatë vlerësimit për të nxënë nuk ndihmon procesin e të nxënësit, motivimin e nxënësve për të nxënë dhe zhvillimin e kompetencave.

Fletorja personale (evidenca) **është objekt monitorimi, por nuk** dorëzohet në përfundim të periudhës. Mësuesi **mban përgjegjësi për fletoren personale** dhe duhet të argumentojë kodin e shkallës së vlerësimit (për klasat I-III) dhe notën e vlerësimit të vazhduar (për klasat IV-V) të vendosur në regjistër. Mësuesi duhet **të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor** fletoren personale (evidencën), testet/detyrat e ndërmjetme, punët me shkrim etj. Këto do t'i shërbejnë për të argumentuar vlerësimet e bëra në regjistër.

Drejtuesit e shkollave nuk duhet të ngarkojnë mësuesit me detyrimin për të mbajtur dy dokumente për vlerësimin e vazhduar të nxënësve: evidencën e vlerësimit të vazhduar dhe fletoren personale të shënimeve, pasi ato janë e njëjta gjë.

Mësuesi e përcakton vetë formatin (evidencën) ku do t'i mbajë shënimet: në fleta formati A4, A3, në fletore etj.; nëse do t'i mbajë për secilin nxënë në mënyrë të veçantë apo për të gjithë klasën si në një regjistër. Gjithashtu, mësuesi e përshtat



formatin në varësi të specifikave të lëndëve, por duke ruajtur pjesën përmbajtësore. Rubrikat që duhet të përfshihen në evidencë për secilën lëndë janë:

- Emri/at dhe mbiemri/at i/e nxënësit/ve të klasës
- Datat për të bërë vlerësimin e nxënësve
- Hapësirat e nevojshme për të vendosur *shprehjen vlerësuese, simbolin, kodin ose notën.*
- Përcaktimi nëse nxënësi është vlerësuar për përgjigjen që ka dhënë me gojë, për një detyrë me shkrim, për një projekt, në një punim, në një test, diktim, përsëritje, për një bashkëpunim etj.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin e nxënësve në çdo orë mësimi dhe për çdotemë mësimore. Për të bërë vlerësimin e arritjeve të nxënësit në fund të secilës periudhë të vitit, mësuesi bazohet në vlerësimet e bëra përgjatë tij, duke iu referuar performancës së plotë të nxënësit për përgjigjet me gojë, punët me shkrim, punimet individuale dhe projektet në grup. Nivelet e arritjes bazohen në rezultatet e të nxënimit të kompetencave për secilën fushë të nxëni. Atoshprehin kritere të njësuara për vlerësimin e njohurive, të shkathtësive dhe të qëndrimeve të nxënësve sipas fushave përkatëse. Këto nivele i ndihmojnë mësuesit të përcaktojnë nivelin e arritjes së kompetencave nga nxënësit, të vlerësojnë mundësitë e tij për t'u përmirësuar dhe për të përparuar.

Vlerësimi i nxënësve, i bazuar në nivele arritjesh, krijon besim në gjykimet e mësuesve, jepsigurite prindërit dhe të tjerët që të gjithë nxënësit i kanë arritjet e tyre në përputhje me pritshmëritë. Nivelet e arritjeve synojnë të matin se sa arritjet e nxënësve përputhen me arritjen e dëshiruar (e pritshme) prej tyre në një lëndë të caktuar të arsimit fillor.

# DISA SUGJERIME PËR NJË MËSIMDHËNIE TË FRYTSHME

Në punën mësimore, përdorimi i metodave çon në realizimin e qëllimeve dhe të detyrave edukative dhe arsimore. Metodatat ndërvepruese ndikojnë edhe në formimin e personalitetit të nxënësve, duke i aftësuar dhe përgatitur ata për jetë dhe për punë. Përzgjedhja e metodave/teknikave gjatë procesit mësimor është etapë shumë e rëndësishme e organizimit të orës mësimore.

Kriteret të cilat na ndihmojnë në përzgjedhjen e metodave/teknikave mësimore, janë:

- lënda mësimore;
- përmbajtja mësimore;
- tipi i orës mësimore;
- etapa e organizimit të punës mësimore gjatë orës mësimore;
- mosha dhe shkalla e zhvillimit psikofizik të nxënësve;
- numri i nxënësve në klasë;
- forma didaktike e organizimit të punës mësimore;
- koha në dispozicion për përdorimin e metodës përkatëse mësimore;
- pajisja e shkollës me bazë materiale për organizimin e punës mësimore në klasë;
- aftësia profesionale dhe pedagogjike e mësuesit dhe e bashkëpunëtorëve mësimorë.

Metodat ndërvepruese lidhen me të nxënësit aktiv dhe promovojnë një mësimdhënie më cilësore që mbështetet në elemente të ndryshme të mësimin problemor, kërkimor, ku nxënësit udhëzohen të punojnë në grupe apo në mënyra individuale. Metodatat ndërvepruese të organizimit të mësimin janë karakteristike të metodave bashkëkohore.

## **Hapat që duhet të ketë parasysh mësuesi për përdorimin e metodave ndërvepruese**

- Strukturimi i përmbajtjes së temës mësimore, planifikimi i orës;

- Gjithëpërfshirja e nxënësve në orën e mësimit;
- Zbatimi i njohurive teorike me shembuj të situatave të jetës reale;
- Pjesëmarrja aktive e nxënësve në procesin mësimor;
- Transformimi i klasës në një mjedis të nxënësve aktiv;
- Përdorimi masiv i teknologjive.

Mësuesit për të zbatuar me efikasitet programin mësimor duhet të kenë aftësitë e duhura për të përdorur metodat bashkëkohore ndërvepruese në çdo orë mësimore.

### ***Përparësitë e përdorimit të metodave ndërvepruese***

a) Sigurimi i një përqendrimi të lartë të nxënësve në orën e mësimit.

Metodat ndërvepruese e bëjnë më interesante orën e mësimit dhe nxisin interesin dhe përqendrimin e nxënësve. Nëpërmjet ndërveprimit mundësojmë të përfshijmë në pjesëmarrje aktive edhe nxënësit që kanë probleme me sjelljen (nxënës hiperaktivë, nxënës me vështirësi në të nxënë).

b) Rritja e vlerësimit dhe e vetëvlerësimit

Përdorimi i metodave ndërvepruese i bën nxënësit më të përgjegjshëm, pjesëmarrës aktivë në punën në grup, duke i bërë shumë bashkëpunues me njëri-tjetrin.

### ***Roli i mësuesit gjatë përdorimit të metodave ndërvepruese në procesin mësimor***

- Organizues i orës mësimore
- Udhëheqës i procesit mësimor për drejtimin, orientimin dhe udhëzimin e nxënësve
- Partner me nxënësit gjatë komunikimit dhe ndërveprimit në klasë
- Motivues për të siguruar progresin e secilit përmes një bashkëpunimi të suksesshëm
- Vlerëson nxënësit dhe i motivon ato për të vetëvlerësuar veten e tyre.

### ***Roli i nxënësit gjatë përdorimit të metodave ndërvepruese në procesin mësimor***

- Planifikon detyrat e tij dhe merr përgjegjësinë për kryerjen e tyre brenda afateve të caktuara.
- Monitoron, vlerëson dhe rishikon planifikimet e tij për të përfunduar detyrat e ngarkuara dhe për të përmbushur qëllimet.
- Ndjek me përpikmëri udhëzimet që i jepen nga mësuesi.
- Pranon role të ndryshme dhe ndihet i barabartë me të gjithë gjatë kryerjes së punëve në grup.
- Pranon me pozitivitet idetë, opinionet, vlerat dhe traditat e të tjerëve.
- Shpreh aftësitë e tij për risi dhe është i gatshëm për të marrë përsipër detyra edhe përballë risqeve.
- Demonstron kureshtje dhe interes në mësim gjatë gjithë kohës mësimore.
- Identifikon, mbledh, vlerëson dhe përdor informacione të ndryshme, të cilat i shërbejnë si burime ndihmëse për kryerjen e detyrave.
- Ndërton marrëdhënie të shëndetshme në komunikimin me të tjerët.
- Zhvillon të menduarin kritik për të zgjidhur problemet dhe është i aftë për marrjen e vendimeve.
- Vlerëson dhe pasqyron në mënyrë kritike pikat e forta të tij.

# PROJEKTET KURRIKULARE

Projekti kurrikular ka karakter kërkimor e krijues. Ai nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimitetj. Gjatë projektit, nxënësi në mënyrë të pavarur ose në grup hulumton mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti kurrikular është rubrikë e detyruar e portofolit të të nxënit.

Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tria periudhat, por mund të jetë i shtrirë dhe vetëm brenda një periudhe. Zbatimi i një projekti në një lëndë të caktuar kërkon më shumë se një orë mësimore. Sido që të jetë shtrirja e projektit, ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit gjatë zhvillimit të tij.

*Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar. Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe vlerësohet i gjithë projekti.*

Projekti kurrikular kërkon që mësuesi:

- të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (sepse çdo nxënës duhet të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara);
- të paraqesë rezultatet e të nxënit që do të arrihen nëpërmjet projektit;
- të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit;
- të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit;
- të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit;
- të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.

Projekti kurrikular realizohet duke iu kërkuar nxënësve të shfrytëzojnë përvojat vetjake dhe njohuritë e marra nga burime të ndryshme. Projekti kurrikular realizohet

duke përdorur më shumë se një metodë apo teknikë mësimdhënieje, si: *kërkimi, intervista, puna në grup, puna individuale, përpunim informacioni* etj.

**Fazat kryesore** që ndiqen për realizimin e një projekti janë:

- Përcaktimi i çështjes ose problemit për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
- Përcaktimi i detyrave që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
- Grumbullimi i materialeve dhe/ose mjeteve të nevojshme.
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave të grumbulluara.
- Nxjerrja e përfundimeve dhe përgjithësimeve nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitja e produktit përfundimtar.
- Prezantimi i gjetjeve dhe përfundimeve të projektit ose prezantimi i produktit të krijuar.

Për planifikimin e një projekti mësuesi **ndërton planin e projektit**, rubrikat kryesore të të cilit paraqiten më poshtë. Në varësi të tematikës së projektit dhe specifikave të tij mësuesi mund të pasurojë planifikimin edhe me rubrika të tjera. Mësuesi planifikon në planin e tij ditor çdo orë të planifikuar të projektit sikurse vepron me orët e tjera mësimore.

Rubrikat kryesore të planifikimit të një projekti kurrikular janë:

- *Tema e projektit:* Përcaktohet nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësit.
- *Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore:* Nëse projekti është ndërleëndor, përcaktohet kontributi i çdo mësuesi dhe orët mësimore për secilën lëndë.
- *Klasa/t pjesëmarrëse:* Përcaktohet klasa ose në rast se ka disa klasa.
- *Rezultatet e të nxënës:* Përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të zhvillohen përmes veprimtarive të projektit.
- *Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:* Përcaktohen konceptet që duhet të zotërojë nxënësi për realizimin e këtij projekti.
- *Partnerët:* Nëse ka partnerë, p.sh., nëse projekti ka si qëllim që nxënësit të hulumtojnë lidhur me muzikën e zonës ku jetojnë, një specialist i muzikës mund të jetë një partner pjesëmarrës në projekt.

- *Veprimtaritë kryesore:* Përcaktohen veprimtaritë që do të realizohen gjatë projektit.
- *Burimet kryesore të informacionit:* Mësuesi duhet të orientojë nxënësit drejt përdorimit të burimeve të larmishme dhe të duhura të informacionit.
- *Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:* Këtu vendoset tematika për çdo orë mësimore të projektit. P.sh.: nëse projekti planifikohet në 3 orë atëherë duhet vendosur tematika për të tria orët.
- *Përshkrimi i produktit të projektit:* Duhet përfshirë shkurtimisht lloji i produktit që pritet të realizohet dhe mënyrën e prezantimit të tij.
- *Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:* Mësuesi përcakton kritere për vlerësimin e projektit të cilat ia komunikon nxënësit që në fillim të tij. Kriteret e përcaktuar duhet të kenë lidhje me trajtimin e përmbajtjes, përdorimin e burimeve të informacionit, përgatitjen e produktit, prezantimin e tij etj., në varësi të rezultateve të të nxënit.

# PORTOFOLI I NXËNËSIT

Në arsimin fillor, portofoli i tënxënit koleksionon të gjitha kontributet, arritjet e nxënësiveveprimtaritëqë ai kryen nëklasë, nështëpi, punët me projekte, detyra krijuese, teste, detyra përmbledhëse, vlerësuese etj.

Në arsimin fillor, **është mësuesi ai që përcakton numrin dhe llojin e detyrave që bëhen pjesë e portofolit, duke u mbështetur në rubrikat e planifikimit sipas tri periudhave** “Për çfarë i vlerësojmë nxënësit” dhe “Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/ lëndës”.

Punimet dhe detyrat e koleksionuara në portofol janë mjete që i ndihmojnë nxënësit të zbulojnë anët e forta, dobësitë, mangësitë, vështirësitë dhe problemet që hasin gjatë procesit të punës. Ato dëshmojnë përparimin e nxënësve, aftësitë e tyre si dhe mundësitë për t’u përmirësuar më tej.

Mbajtja e portofolit personal dhe grumbullimi i materialeve është një mundësi e mirë edhe për prindërit për të njohur realisht përparimin e fëmijës së tyre, si dhe ku duhet të punojnë e t’i ndihmojnë më tej. Përkëtë arsye që në fillim të vitit shkollor, pjesë e rubrikave të portofolit, ështënjërubrikë ku përfshihen shënimet dhe vlerësimet e mësuesit si dhe komentet e prindërve.

Portofoli i nxënësit nuk është thjesht një koleksion ose mbledhjesh punimesh të rastësishme, por është një koleksion i qëllimshëm i punës së nxënësve, që tregon përpjekjet, arritjet, përparimin në një ose disa fusha apo lëndë. Zhvillimi dhe formimi i tyre nuk shfaqet vetëm në produktet përfundimtare. Ai është proces në vazhdim, që pasurohet çdo ditë.

## Organizimi i portofolit të nxënësit për klasat I-III

Organizimi i portofolit në rubrika lehtëson procesin e koleksionimit dhe të vlerësimit tënxënësit, ndikon në përcaktimin e kritereve dhe të peshave tëçdo rubrike, rrit transparencën me prindërit dhe nxënësit në lidhje me vlerësimin, si dhe zhvillon aftësitë e nxënësitpërtë qenë i strukturuar.



Rubrikat e portofolit për klasat I-III janë:

- Punime dhe detyra të realizuara në shtëpi (15% të vlerësimit)
- Punime dhe detyra të realizuara në klasë (30% të vlerësimit)
- Punime tematike/ projekte dhe punime individuale të nxënësit (25% të vlerësimit)
- Teste dhe detyra përmbledhëse (30% të vlerësimit)

Punimet që futen në portofol janë të larmishme dhe i japin mundësi çdo nxënësi të shfaqë dhe të tregojë çfarë di dhe çfarë është në gjendje të bëjë. Punimet dhe detyrat e shtëpisë dhe të klasës që futen në portofol, kanë lidhje me përmbushjen e rezultateve të të nxënës të programeve lëndore të arsimit fillor dhe përcaktohen nga mësuesi.

Punimet tematike/ projektet dhe punimet individuale janë sa të orientuara nga mësuesi, aq edhe të zgjedhura nga vetë nxënësi që dëshmojnë interesin e tij për të nxënë dhe bashkëpunimin në grup. Në të gjitha detyrat dhe punimet, vlerësimi i nxënësit në klasat I-III bëhet me shprehje vlerësuese.

Për klasat I-III, vlerësimi i nxënësit bëhet mbi bazën e portofolit të të nxënës, si dhe të shënimeve që mësuesi mban për aktivizimin dhe ecurinë e çdo nxënësi.

## Rubrikat e portofolit për klasën IV -V

Për klasat IV-V, funksioni i portofolit të të nxënës lidhet me koleksionimin vetëmtë detyrave komplekse apo projekteve, hulumtimeve tëvetënxënës apo tëzbatimeve praktike. Detyrat e portofolit nuk janë pjesë e vlerësimit të vazhduar të nxënës. *Për një periudhë, detyrat që vlerësohen nëportofol janë projekti ose një fazë e tij dhe 1 -2 detyra krijuese, zbatuese, hulumtuese etj. (P.sh., në lëndët me 1-2 orënë javë portofoli mund të përmbajë një detyrë hulumtuese dhe një fazë të projektit lëndor ose gjithë projektin, ndërsa në lëndët me më shumë se 2 orë, portofoli mund të përmbajë 2 detyra hulumtuese dhe një fazë të projektit lëndor ose gjithë projektin, nëse është projekt i vogël).* Detyrat e portofolit duhet të jenë me të njëjtën temë për çdo nxënës. Detyrat e portofolit mund të jenë punime të kryera në klasë dhe/ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënës, me karakter hulumtues dhe krijues të tilla si:

- punë praktike individuale,
- produkte të krijuara nga nxënësit,
- punime audio-vizuale,
- aktivitete në grup ose individuale,
- projekte individuale ose në grup etj.

*Kujdes! Detyrat **NUK** duhet të jenë domosdoshmërisht të punuara me kompjuter.*

## Dokumentimi dhe vlerësimi i portofolit të nxënësit në klasat

### IV-V

Në fillim të periudhës, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, përcakton detyrat që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës dhe kriteret e vlerësimit të portofolit. Vlerësimi i secilës detyrë të portofolit bëhet mbi bazë të kriterëve që mësuesi vendos, duke u bazuar në llojin e detyrës së dhënë. Nxënësit duhet ta dinë që ata vlerësohen për *cilësinë e materialeve dhe të punimeve; për seriozitetin e përgatitjes së portofolit; për gjetjet origjinale; për aftësinë për të shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni; për aftësinë për të rishikuar e për të mbrojtur punën e bërë; për aftësinë për të bërë vetëvlerësim, vlerësimin e punës së shokëve etj.*

Mësuesi ka përgjegjësi për vlerësimin e portofolit bazuar në kriteret e vlerësimit duke argumentuar notën e tij. Instrumentet që mësuesi harton për kriteret e vlerësimit të portofolit, **nuk janë objekt monitorimi**. Detyrat e portofolit apo një fazë e projektit vlerësohen në momentin që ato dorëzohen ose prezantohen. Vlerësimi i portofolit mund **të planifikohet si orë e veçantë** në planifikimin e periudhave ose mund të realizohet përgjatë tri - katër orëve mësimore të periudhës. Mësuesi duhet të kujdeset që **të mos mbingarkojë nxënësin me detyra** në përfundim të periudhës. Vlerësimi i portofolit **jodomosdoshmërisht** bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e gjykon vetë kohën se kur do të zhvillojë vlerësimin e portofolit. Në momentin që mësuesi ka përfunduar me **vlerësimin e detyrave të portofolit dhe të projektitose të një faze të tij**, notat e portofolit i vendos në regjistër. Mësuesi duhet t'i udhëzojë nxënësit që t'i ruajnë detyrat e portofolit deri në përfundim të vitit shkollor ose t'i mbajnë vetë këto detyra.

## Diskutimi i punimeve dhe i detyrave të portofolit

Rishikimi i portofolit mund të bëhet në mënyrë individuale, në çifte ose në grupe të vogla prej 4-5 nxënësish. Koha mund të variojë nga 1-3 herë, për çdo periudhë. Diskutimet për detyrat dhe punimet e portofolit, mësuesi mund t'i zhvillojë kokë më kokë me secilin nxënës, në çifte ose në grupet e punës në të cilat kanë punuar. Për të vendosur se si do të procedojë, mësuesi duhet të pyesë nxënësin, të marrë parasysh dhe t'i respektojë kërkesat e tij. Në këto diskutime, mësuesi dëgjon me vëmendje shpjegimet e nxënësve, ua sheh portofolin me qetësi, i pyet për çështje të ndryshme dhe në fund u jep sugjerime sesi mund të vazhdojë më tej. Është mirë që në këto takime të ftohen edhe prindërit. Ata duhet të përballen me punën, përpjekjet dhe mundësitë e fëmijës së tyre dhe të shohin se ku mund t'i ndihmojnë ata.

## Komunikimi i rezultateve të prindërit

Në fillim të çdo viti shkollor, mësuesi organizon një seancë informimi me prindërit, në të cilën u shpjegon mënyrën e vlerësimit të nxënësve, mënyrën se si do të organizohet ky vlerësim, ndihma që mund të japin prindërit, si dhe objektivat që priten të arrihen nëpërmjet realizimit të këtij vlerësimi. Pra, forma më e mirë për të informuar prindërit dhe për të qenë në kontakt të vazhdueshëm me ta është diskutimi në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me atë çfarë kanë arritur apo po ndeshin vështirësi nxënësit. Gjatë takimeve mujore me prindërit, mësuesit u vënë në dispozicion prindërve dosjen e fëmijës së tyre, duke dhënë edhe shpjegime, mbështetur në shënimet që ka mbajtur në fletoren e tij. Gjithashtu, shihet e rëndësishme dhe e arsyeshme që nxënësi të jetë pjesë e këtyre diskutimeve përveç rasteve ku prindi dhe mësuesit mendojnë që duhet të flasin pa praninë e tij.

Është e këshillueshme që prindërit dhe mësuesit të realizojnë takime të përmuajshme, në mënyrë që t'u shpjegojnë prindërve arritjet e nxënësve. Ndërkohë mësuesit mund të kërkojnë takime të veçanta për nxënës të veçantë kur shohin që fëmija nuk realizon detyra të caktuara në lëndë të caktuara. Edhe prindi, gjithashtu, ka të drejtën të kërkojë takime të posaçme kur konstaton që fëmija ka vështirësi në arritjen e rezultateve të të nxënit.

# TESTET<sup>6</sup>

Testi është një vlerësim formal, përmbledhës, i strukturuar i arritjeve të nxënësit dhe i progresit të tij. Testet u lejojnë nxënësve të monitorojnë progresin e tyre dhe ofron informacion të vlefshëm për mësuesin në planifikimin e mëtejshëm të procesit mësimor. Ato ndihmojnë në nxënien e nxënësve nëse ato janë të lidhura qartë me mësimin dhe rezultatet e të nxënësve. Dëshmitë tregojnë se teste të shkurtra janë më efektive për progresin e nxënësve se sa një test i gjatë. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që testet të korrigjohen dhe nxënësve t'u jepet informacion për ecurinë e tyre. Testet e hartuara në klasë zbulojnë rreth njohurive të nxënësve për përmbajtjen dhe për zhvillimin e të menduarit. Përgjithësisht pyetjet e hapura japin informacion më të detajuar në lidhje me aftësitë e nxënësve sesa një pyetje në të cilën ka vetëm një përgjigje.

## Parimet e hartimit të testeve

Testet lejojnë shumëllojshmëri mënyrash të demonstrimit të aftësive të nxënësve prandaj:

- nxënësit duhet të kuptojnë qëllimin dhe vlerën e testit;
- testi duhet të masë arritjen e rezultateve të të nxënësve për një kapitull ose periudhë të caktuar;
- duhen dhënë udhëzime të qarta për secilën pjesë të testit;
- pyetjet duhet të renditen nga më e thjeshta te ajo më komplekse;
- pikët duhet të jepen për çdo pyetje apo rubrikë të testit;
- pyetjet duhet të jenë të llojeve të ndryshme.

Testet:

- duhet të jenë të lehtë për t'u lexuar dhe të kenë hapësirë ndërmjet pyetjeve për të lehtësuar leximin dhe shkrimin;
- duhet të përfshijnë një sërë rezultatesh të nxënësve;
- mund të kryhen edhe nga nxënësit me nevojë të veçanta;

---

<sup>6</sup>Modele testesh për lëndë të ndryshme të arsimit fillor, mësuesi i gjen në web-in e ASCAP-it.

- duhet t'u krijojnë mundësi nxënësve të zgjedhin kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të pavarur nga njëra – tjetra;
- duhet të kenë nivele të ndryshme pyetjeshpër të përfshirë mbledhjen, përpunimin dhe zbatimin e informacioneve;
- duhet të llogariten me kohë të mjaftueshme për të përfunduar të gjithë nxënësit;
- duhet të mos ngatërrohen me minitestet, të cilat masin rendimentin e orës së mësimit dhe kanë vetëm një kërkesë.

Gjatë ndërtimit të testeve të arritjes për një grup njohurish lëndore, mësuesi duhet të ketë në konsideratë:

- ➔ Numri i pyetjeve në teste varet nga ajo çfarë do të testohet. Ky numër është i ndryshëm kur synohet testimi i përvetësimit të një koncepti, i përvetësimit të një mësimi, i përvetësimit të një kapitulli, i përvetësimit të lëndës së një periudhe etj.
- ➔ Pyetjet në test radhiten sipas shkallës së vështirësisë së tyre.
- ➔ Numri i pyetjeve të testit varet edhe nga koha në dispozicion, kjo kohë mesatarisht duhet të jetë 45 minuta.
- ➔ Gjatë hartimit të një testi është shumë e rëndësishme vlefshmëria e pyetjeve të tij (d.m.th. garantimi i asaj që testi në tërësi duhet të vlerësojë ato koncepte, njohuri, aftësi e shprehje që ne i kemi vënë vetes si qëllim të kontrollojmë).

## Hartimi i testit

Hartimi i testit kalon në disa hapa.

**Hapi i parë** është përcaktimi i listës së koncepteve që do të testohen me peshën përkatëse (% e pikëve që do të zërë secilin koncept kryesor në test), si dhe rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave lëndore që do të testohen, diagnostikohen.

**Hapi i dytë** është përcaktimi i peshës së niveleve që do të zbatohet në test.

**Tabela 24. Shpërndarja e peshave sipas niveleve për klasat I-III dhe IV-V**

Klasat	Niveli II	Niveli III	Niveli IV	Niveli V
I-III	30-35 %	35-40 %	15-20 %	10 %
IV-V	35-40 %	35-40 %	15-25 %	-

Niveli i dytë i arritjes së kompetencave përfshin pyetje ku kërkohet që nxënësi të zbatojë një procedurë rutinë, mjaft të ushtruar në klasë. Niveli i tretë i arritjes së kompetencave përfshin pyetjeshku nxënësiduhet të ndjehet para një situatë më komplekse, të cilën, do ta zgjidhë duke kombinuar njohuritë që disponon. Niveli i katërt dhe i pestë i arritjes së kompetencave përfshin pyetje ku nxënësi gjykon, zgjidh, jep mendim, vlerëson, krijon, harton duke vënë në dispozicion njohuritë e tij.

**Hapi i tretë** është ndërtimi i tabelës së specifikimeve (*blueprint-i*).

**Tabela 25. Tabela e specifikimeve (Blueprint-i)**

Konceptet	Përqindja e konvertuar në pikë	Rezultatet e të nxënit	Pesha e pyetjeve të nivelit II të arritjes së kompetencave	Pesha e pyetjeve të nivelit III të arritjes së kompetencave	Pesha e pyetjeve të nivelit IV <sup>7</sup> të arritjes së kompetencave
.....	....	.....	.....	.....	.....
Pikët total të testit	100% = __ pikë	• ... • ...	X %= __ pikë	Y %= __ pikë	Z% = __ pikë

**Hapi i katërt** është hartimi i pyetjeve të testit. Pyetjet që mund të përdoren në test, janë:

- Pyetje me alternativa (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 alternativat). Një pyetje me alternativa përbëhet nga dy pjesë: trunçu dhe përgjigjet alternative ndër të cilat dallohet përgjigja e vetme e saktë. Alternativat duhet të vendosen vertikalisht pas përmbajtjes së pyetjes, në përputhje me rendin alfabetik. Nuk duhet të përdoren alternativa që përplasen me njëra - tjetrën. Pyetjet ndërtohen

<sup>7</sup>Për klasat I-III llogaritet edhe pesha e pyetjeve të nivelit V të arritjes së kompetencave.

në përgjithësi me 4 alternativa. Alternativat duhet të kenë gjatësi të njëjtë, duhet të jenë homogjene dhe t'í referohen të njëjtës kategori. Në alternativa nuk duhet të ketë mbivendosje të dhënash apo intervalesh kohore. Pyetjet me alternativë vlerësohen me një pikë. Ato shmangin në shkallë të lartë subjektivitetin në pikëzim.

- Pyetje me përgjigje: *E vërtetë/ E rreme; Po/Jo; E saktë/ E gabuar*. Përgjigja e saktë për këto lloj pyetjesh vlerësohet me një pikë.
- Pyetje me kombinime (me çiftim).Për çdo çiftim të saktë jepet një pikë, pra nëse ushtrimi ka 4 kombinime nga të dyja kolonat, nxënësi do të marrë 4 pikë, nga 1 për çdo kombinim të saktë.
- Pyetje me plotësimin e vendeve bosh me informacionin e duhur nga një përkufizim apo proces.Për çdo plotësim të saktë jepet një pikë.
- Pyetje me zëvendësim, zëvendësimi i një zgjidhje me të ngjashmen e saj. Për çdo zëvendësim të saktë jepet një pikë.
- Pyetje me përgjigje (zgjidhje) të shkurtër. Formulimi i tyre kërkon një përgjigje të përcaktuar e të përpiktë. Këto pyetje kërkojnë nga 1 deri në 5 minuta kohë për t'u lexuar e për t'u përgjigjur. Këtu hyjnë pyetje në të cilat nxënësit i kërkohet të bëjnë një figurë, të kryejnë një njehsim, të paraqesë shkurt një argumentim, të zgjidhë një ushtrim etj. Këto lloj pyetjesh kërkojnë më shumë se një miratim të thjeshtëose një kujtesë mekanike. Ka më pak mundësi që nxënësit ta gjejnë përgjigjen me hamendje në krahasim me pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë.
- Pyetje subjektive me përgjigje të kufizuar. Këto lloj pyetjesh i kanë disa përgjigje të sakta, të cilat duhen gjetur nga nxënësit.
- Pyetje subjektive me përgjigje të zgjeruar. Këto lloj pyetjesh mund të kenë disa përgjigje të sugjeruara nga nxënësit. Në këtë rast vlerësohen argumentet që jep nxënësi dhe saktësia në arsyetimin e mendimeve dhe e veprimeve përkatëse.
- Si rregull në pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë (1 pikë) *llogariten 60 sekonda*; për pyetjet e tjera për çdo pikë e dhënë llogaritet *90 sekonda*. Koha për përgjigjen e testit në tërësi përcaktohet paraprakisht duke mbajtur parasysh moshën e nxënësve, nivelin e shprehive të fituara nga nxënësit, shmangien e kopjimit prej tyre etj.

- Nëse gjatë testimit do të lejohet përdorimi i mjeteve si p.sh. makina llogaritëse, vizore, kompasit etj, kjo duhet të përcaktohet më parë dhe të jepen udhëzimet sa dhe si do të përdoren ato.

Pyetjet duhet të jenë me një nivel të përshtatshëm vështirësie (kufiri i përshtatshëm është që 20% - 80% e nxënësve t'i përgjigjen saktë pyetjes).

**Hapi i pestë** është përcaktimi i skemës së vlerësimit (bazuar në shpërndarjen normale). Sistemi i pikëzimit që përdoret më shumë është ai që quhet analitik. Dynga elementet bazë të këtij sistemi janë:

- caktimi i pikëve për konceptet që testohen;
- skema e pikëzimit (ku jepen kriteret e shpërndarjes së pikëve që janë akorduar për konceptet që do të testohen, duke pasur parasysh për bazë përgjigjen e saktë që duhet të jepet për këtë çështje).

Në konvertimin e pikëve me nota, kufiri i poshtëm rekomandohet 25% e totalit të pikëve.

**Tabela 26. Intervalet e pikëve të testit për nivelet e vlerësimit në klasat I-III**

Niveli	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4	Niveli 5
	APK	ANP	AK	AShK	ASh
Përqindja e përgjigjeve të sakta	0-24	25-51	52-64	65-90	91-100

**Tabela 27. Intervalet e pikëve të testit për notat 4 - 10, në klasat 4-5**

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Përqindja e përgjigjeve të sakta	0-24	25-38	39-51	52-64	65-77	78-90	91-100



**ZBATIME TË KURRIKULËS SË RE NË  
KLASAT I-V**

Përvoja nga mësuesit e arsimit fillor

# PLANIFIKIME DITORE

Lënda: Gjuhë shqipe (Abetare)	“Treni i fjalëve”	Shkalla I	Klasa I
<ol style="list-style-type: none"> <li>Punim i faqes 56 të Abetares</li> <li>Veprimtari shkrimi (diktim)</li> </ol>		<b>Situata e të nxënit:</b> Lojë me fjalë	
<b>Rezultatet e të nxënit</b>  Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>gjen, drejtshqipton dhe shkruan fjalë që fillojnë me <b>B, H, T, S, SH, F</b> ose që përmbajnë shkronjën <b>B, H, T, S, SH, F</b> në trup të tyre;</li> <li>bën analizë dhe sintezë të fjalëve;</li> <li>shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë;</li> <li>parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyç të tekstit;</li> <li>rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë atë;</li> <li>shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjën <b>B, H, T, S, SH, F</b> në fillim, në trup të fjalës;</li> <li>lexon fjalë, fjali me shkrim dore.</li> </ul>		<b>Fjalë kyç:</b>  <i>Fjalë, tren, lojë, shkronjë e madhe, shkronjë e vogël, rrokje, diktim</i>  <b>Teknika dhe strategji :</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Loja e shkronjave</li> <li>- Analizë – sintezë e fjalëve, fjalive</li> <li>- Demonstrim</li> <li>- Punë individuale</li> <li>- Punë në çifte/punë në dyshe</li> <li>- Lexim individual</li> </ul>	
<b>Burimet e informacionit dhe mjetet:</b> Fletore e punës, fletore shkrimi, modele shkronjash kolektive dhe individuale, grafiku i shkronjave <b>B, H, T, S, SH, F</b> të shtypit dhe të dorës.		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b>  Edukim fizik, sporte dhe shëndet, Matematikë, Arte.	
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Veprimtari paraprake: 15min</b></li> </ul>			
<b>Hapi 1.</b> Mësuesi shkruan në tabelë shkronjat <b>B, H, T, S, SH, F</b> .			

Nxënësit lexojnë në kor shkronjat e mësuara.

**Hapi 2:** Lojë me top. Nxënësit vihen në rreth dhe i kalojnë topin njëri- tjetrit duke i thënë njërën nga shkronjat **B, H, T, S, SH, F**, shoku/shoqja që pret topin duhet të thotë një fjalë që fillon me të ose që e përmban njërën nga shkronjat e shënuara në tabelë. Disa prej fjalëve shkruhen në tabelë.

- ***Veprimet në situatë: 35min***

**Hapi 3.** Mësuesi nxit nxënësit të emërtojnë figurat dhe të thonë nga një koment të shkurtër për to, duke i ndihmuar me pyetje ndihmëse, si p.sh.:

- *Të pëlqen të luash me balonë?*
- *Ku jeton balena?*
- *Kur del hëna?*
- *Çfarë loje luajmë me top?*
- *Çfarë tregon harta?*
- *Cilat janë ngjyrat e semaforit?*
- *Në cilën stinë piqet fiku? Etj.*

**Hapi 4.** Nxënësit punojnë në mënyrë individuale për shkrimin e fjalëve poshtë figurave. Në çifte kontrollojnë punët e njëri – tjetrit. Lexohen me zë të lartë fjalët. Bëhet ndarja e tyre në rrokje.

**Hapi 5.** Mësuesi shkruan në tabelë titullin e tregimit “Treni i fjalëve” dhe nxit nxënësit të japin mendime për përmbajtjen e tekstit pa e lexuar më parë atë.

**Hapi 6. (15 min)** Mësuesi lexon tekstin me intonacion. Nxënësit ndjekin leximin në libër. Lihen nxënësit të lexojnë për disa minuta tekstin, më pas e lexojnë me zë të lartë atë.

***Krijohet një hapësirë pushimi për të kaluar në veprimtaritë pasardhëse. Organizohet një lojë për tëçlodhur fëmijët.***

***Veprimtari paraprake: 10 minuta***

**Hapi 1.** Përsëritje 6 shkronjave të treta **B, H, T, S, SH, F** të shtypit dhe të dorës.

Nxënësit shkruajnë në fletore bukur grafikun e 6 shkronjave të mësuara të shtypit dhe të dorës. Mësuesi këshillon nxënësit të ruajnë hapësirën midis shkronjave, të mbajnë trupin drejt gjatë shkrimit, të shkruajnë pastër dhe bukur.

Punët më të mira vendosen në një vend të dukshëm.

***Veprimet në situatë: 20 minuta***

**Hapi 2.** Mësuesi shkruan në tabelë një tekst me shkronja shtypi dhe nxënësit duhet ta kopjojnë me shkronja dore ose përgatit fisha për secilin nxënës ku ka shkruar fjalë, fjali, tekst dhe i shpërndan sipas niveleve. Nxënësit punojnë të pavarur. Lihen nxënësit të lexojnë fjalët, fjalitë apo tekstin që ka shkruar.

**Hapi 3.** Përsëri duke kopjuar nga tabela ose në fletë ushtrimesh të përgatitura, mund të punohen këto ushtrime.

***1. Ndaj fjalët në rrokje.***

harta = \_\_\_ + \_\_\_ , banane = \_\_\_ + \_\_\_ + \_\_\_ , krahu = \_\_\_ + \_\_\_ , shkronjat = \_\_\_ + \_\_\_

***2. Plotëso:***

Fla \_\_\_ ri, s \_\_\_ p , \_\_\_ tura, shpor \_\_\_ , sema \_\_\_ ri, lap \_\_\_ ,

***3. Plotëso fjalinë. (hëna, flamuri, semaforin)***

\_\_\_\_\_ duket natën.

\_\_\_\_\_ ynë është kuq e zi.

Duhet të respektosh \_\_\_\_\_ .

***Demonstrim i rezultateve të arritura: 20 minuta***

**Hapi 5.** Diktim me shkronja dore.

Diktim me shkronja dore.

*Bora mbulon tokën.*

*Artani ka kompjuter.*

*Punën e sotme mos e lër për nesër.*

Nëse mjafton koha, nxënësit lexojnë rrokjet, fjalët dhe fjalinë me shkrim dore.

### **Vlerësimi i nxënësit:**

Niveli 2: Shkruan shkronjat **B, H, T, S, SH, F** me të gjitha elementet duke e lidhur me shkronjat e tjera.

Niveli 3: Shkruan fjalë me të kopjuar duke përdorur shkronjat **B, H, T, S, SH, F** në fillim të fjalës.

Niveli 4: Shkruan fjalë duke përdorur shkronjën **B, H, T, S, SH, F** në fillim dhe në trup të fjalës.

Niveli 5: Lexon fjalë, fjali me shkrim dore.

### **Detyrë shtëpie:**

- Shkruaj 3 rreshta me shkronjat **B, H, T, S, SH, F** të dorës.
- Krij një tren fjalësh me shkronjat **B, H, T, S, SH, F**
- Formo fjali me fjalët: *semafori, bora, flamuri, hëna, shkronjat.*

Lënda: Matematikë	Tematika: Numri	2 orë mësimi	Shkalla II	Klasa III
<p><i>Temat mësimore:</i></p> <p>Pjesëtimi me grupe</p> <p>Pjesëtimi si veprim i kundërt i shumëzimit</p>				
<p><i>Rezultatet e të nxënësve:</i></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ paraqet pjesëtimin në rreshtime;</li> <li>▪ emërton kufizat në një pjesëtim: <i>i pjesëtueshmi, pjesëtuesi, herësi;</i></li> <li>▪ zgjidh problemat me pjesëtim;</li> <li>▪ shkruan dy pjesëtime për shumëzimin;</li> <li>▪ gjen kufizat që mungojnë në një pjesëtim të dhënë;</li> <li>▪ krijon problema me shumëzim dhe me pjesëtim njëkohësisht.</li> </ul>			<p><i>Fjalë kyç:</i></p> <p>Pjesëtim</p> <p>i pjesëtueshmi</p> <p>pjesëtuesi</p> <p>herësi</p> <p>ndarje në pjesë të barabarta</p> <p>veprim i kundërt</p>	
<p><i>Burime:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Libri i nxënësit.</li> <li>▪ Kompletin me 100 kartonë</li> <li>▪ Modele demonstruese për mësuesin.</li> <li>▪ Situata të thjeshta me numra</li> </ul>			<p><i>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Art</li> <li>▪ gjuha dhe komunikimi</li> <li>▪ edukim fizik</li> </ul>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Situata e të nxënësve:</b></li> </ul> <p>Kompletin e kartonëve fëmijët e përdorin që në klasë të dytë për shumëzimet.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Organizimi i orës së mësimi</b></li> </ul> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: <i>Vëzhgo – diskuto - nxirr përfundime-</i></p>				

Koha 10 minuta.

Veprimtari 1:

Nxënësit nxjerrin mbi bankë kartonët dhe formojnë me to rreshtime për shumëzimet

$4 \times 5$  ;  $6 \times 5$  ;  $4 \times 4$  etj.

Punë në grupe

▪ Veprimtari 2

Rreshtohen 15 kartonë duke i ndarë në rreshta me 3 kartonë për secilin rresht.

Nxënësit gjejnë sa rreshta janë.



Shkruhet pjesëtimi në tabelë:  $15 : 3 = 5$



15 - i pjesëtueshmi



3 - pjesëtuesi



5 - herësi



▪ Veprimtari 3: Ndahet klasa në 4 grupe:

Grupi 1 Ndani në disa mënyra 24 rrathë.	Grupi 2 Ndani në disa mënyra 20 rrathë.
Grupi 3 Ndani në disa mënyra 36 rrathë.	Grupi 4 Ndani në disa mënyra 18 rrathë.

Veprimtari 4

Shpërndahen fisha me problema për secilin grup. Nxënësit kryejnë në grup situatën e

shpërndarë.

*Grupi 1.* Një klasë ka 36 nxënës. Këta u ndanë në grupe me nga 9 nxënës secili. Sa grupe u formuan?

*Grupi 2.* Një klasë ka 32 nxënës. Këta u ndanë në grupe me nga 8 nxënës secili. Sa grupe u formuan?

*Grupi 3.* Një klasë ka 21 nxënës. Këta u ndanë në grupe me nga 7 nxënës secili. Sa grupe u formuan?

*Grupi 4.* Një klasë ka 28 nxënës. Këta u ndanë në grupe me nga 7 nxënës secili. Sa grupe u formuan?

Shkruhen në tabelë barazimet për secilën problemë:

$$36 : 9 = 4 \quad 32 : 8 = 4 \quad 21 : 7 = 3 \quad 28 : 7 = 4$$

- Veprimtari 5

Për secilin nga pjesëtimet shkruani dy shumëzime:

$$36 : 9 = 4 \quad 32 : 8 = 4 \quad 21 : 7 = 3 \quad 28 : 7 = 4$$

$$9 \times 4 = 36 \quad 8 \times 4 = 32 \quad 7 \times 3 = 21 \quad 7 \times 4 = 28$$

$$4 \times 9 = 36 \quad 4 \times 8 = 32 \quad 3 \times 7 = 21 \quad 4 \times 7 = 28$$

Veprimtari çlodhëse 5 minuta

- **Veprimtari e drejtuar**

→ Veprimtari 1

Rreshtoni katrorët në 4 rreshta me nga 5 katrorë rreshti.

Sa katrorë u përdorën ?  $4 \times 5 = 20$ .

Këto 20 katrorë i ndani në grupe të barabarta ose në rreshta të barabarta dhe në secilin grup ose rresht vendosni 5 katrorë.

Sa grupe u formuan?  $20:5 = 4$



Pjesëtimi është e kundërta e shumëzimit, atë që e rreshtuam, e grupuam, e shumëfishuam e ndajmë në pjesë të barabarta pra, e pjesëtojmë.

→ Veprimtari 2

Nxënësit përdorin tabelën e shumëzimit. Marrin fakte të ndryshme shumëzimi nga tabela e shumëzimit dhe për secilin shumëzim të përpiqen të gjejnë dhe të shkruajnë dy pjesëtime.  $3 \times 6 = 18$  ;  $18:3= 6$ ;  $18:6 =3$  etj.

→ Veprimtari 3

Nxënësve u shpërndahet një grup me tre numra ku nxënësit do të shkruajnë dy barazime me shumëzim dhe dy me pjesëtim.

$5 \times 6 = 30$ ;  $6 \times 5= 30$ ;  $30:5 = 6$ ;  $30:6 = 5$

→ Punë e pavarur

Hapet libri.

Nxënësit kryejnë keto veprimtari në libër:

- Plotësojnë pjesëtimet.
- Krijojnë problemë me pjesëtim me një nga faktet e shumëzimit në tabelë.
- Pasi përfundojnë plotësimin e librit bëhet korrigjimi me gojë.

→ Punë në grupe

Nxënësit ndahen në 4 grupe:

Detyrë: Krijimi i një probleme me pjesëtim Diskutohet për çdo lloj veprimtarie pune që kryhet nga nxënësit. Bëhet vlerësimi i punës në mënyrë të vazhduar nga mësuesja.

**Vlerësimi:**

Nxënësi:

N 2 – paraqet pjesëtimin në rreshtime; emërton me ndihmën e mësuesit, kufizat

në një pjesëtim: *i pjesëtueshmi, pjesëtuesi, herësi*.

N 3 – emërton kufizat në një pjesëtim: *i pjesëtueshmi, pjesëtuesi, herësi*; zgjidh problema të thjeshta me pjesëtim.

N 4 – zgjidh problemat me pjesëtim; shkruan dy pjesëtime për shumëzimin.

N 5 – gjen kufizat që mungojnë në një pjesëtim të dhënë, si dhe krijon problema me shumëzim dhe me pjesëtim njëkohësisht.

Lënda: Muzikë	2 orë mësimi	Shkalla II	Klasa IV
Tematika: Teknika dhe procese		Situata e të nxënit: Karakteristikat e zërit të bukur – nxiten nxënësit të dëgjojnë e të flasin për llojet e zërave që ata pëlqejnë më shumë duke shpjeguar disa karakteristika të zërit të bukur.	
Tema mësimore: Kënga “Bilbili dhe gjinkalla”			
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ diskuton lidhur me tekstin e këngës;</li> <li>▪ këndon këngën ritmikiisht dhe melodikiisht;</li> <li>▪ interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion;</li> <li>▪ këndon vetëm dhe në grup.</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- melodia</li> <li>- ritmi</li> </ul>	
Burimet:			
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kënga në CD</li> <li>▪ Materiale shtesë</li> </ul>			
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>			
Ora e parë			
Hapi I: <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i> - (5 minuta)			
Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, ku mësuesi u kërkon nxënësve të dëgjojnë e të flasin për llojet e zërave që ata pëlqejnë më shumë duke shpjeguar disa karakteristika të zërit të bukur.			
Hapi II: <i>Ndërtimi i njohurive të reja</i> - (30 minuta)			
Vendoset në CD për dëgjim dhe ndiqen hapat e mëposhtëm:			
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dëgjimi i këngës “Bilbili dhe gjinkalla”</li> <li>▪ Mësimi këngës me vargje</li> </ul>			

- Përsëritja e vargjeve të mësuara
- Mësimi dhe këndimi i strofës
- Mësimi dhe këndimi i refrenit
- Këndimi i këngës nga fillimi në fund
- Këndimi i këngës solo dhe në kor

Hapi III: *Reflektimi* (10 minuta)

Përsëritja e këngës nga fillimi në fund.

Ora e dytë

Hapi I: *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve* - (5 minuta)

Ora mësimore fillon nëpërmjet rikujtimit të tekstit të këngës dhe diskutimit lidhur me vargjet që janë pëlqyer më shumë.

Hapi II: *Ndërtimi i njohurive të reja* - (30 minuta)

Vendoset një CD për dëgjim dhe ndiqen hapat e mëposhtëm:

- Ridëgjimi i këngës “Bilbili dhe gjinkalla”
- Përsëritja e vargjeve të mësuara
- Këndimi i këngës nga fillimi në fund
- Interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion
- Këndimi i këngës solo dhe në kor.

Hapi III: *Reflektimi* (10 minuta)

Vlerësimi i interpretimit të këngëve nga njëri-tjetri.

*Vlerësimi*

Nxënësi:

N 2 – diskuton në lidhje me tekstin e këngës;

N 3 – këndon këngë sipas melodisë dhe ritmit të saj;

N 4 – interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion, vetëm dhe në grup.

Dosja me punime personale:

Krijimi i një albumi me foto ku të vendosen shpendë dhe insekte të ndryshme.

Shkrimi i një bashkëbisedimi imagjinar të shpendëve dhe të insekteve midis tyre (të paktën 7 fjali).


# MODELE PROJEKTESH

Shkolla 9-vjeçare "Ismail Qemali", Shkodër

Projektet sipas periudhave	Periudha shtator- dhjetor	Periudha janar- mars	Periudha prill – qershor
<b>Tema e projektit</b>	Revista ime	Skënderbeu, Heroi ynë kombëtar	Lexojmë dhe aktrojmë
<b>Lloji i projektit</b>	Ndërkurrikular	Ndërkurrikular	Ndërkurrikular
<b>Lëndët që integrohen</b>	Gjuhë shqipe Matematikë Edukim për shoqërinë Dituri natyre Art pamor Muzikë	Gjuhë shqipe Matematikë Edukim për shoqërinë Dituri natyre Art pamor Muzikë	Gjuhë shqipe Matematikë Edukim për shoqërinë Dituri natyre Art pamor Muzikë
<b>Kohëzgjatja Sipas lëndëve</b>	Gjuha shqipe 4 orë Matematikë 2 orë Edukim për shoqërinë 1orë Dituri natyre 1orë Art pamor 1orë Muzikë 1orë	Gjuha shqipe 4 orë Matematikë 2 orë Edukim për shoqërinë 1orë Dituri natyre 1orë Art pamor 1 orë Muzikë 1orë	Gjuha shqipe 4 orë Matematikë 2 orë Edukim për shoqërinë 1orë Dituri natyre 1orë Art pamor 1orë Muzikë 1orë

<b>Totali i orëve sipas periudhave</b>	<b>10 orë</b>	<b>10 orë</b>	<b>10 orë</b>
<b>Produktet e krijuara</b>	Orë mësimore model Murale me pamje e postera të ndryshme Filmime në disk Libri i krijuar nga nxënësit	Orë mësimore model Murale me pamje e postera të ndryshme Filmime në disk Libri i krijuar nga nxënësit	Orë mësimore model Murale me pamje e postera të ndryshme Filmime në disk Libri i krijuar nga nxënësit
<b>Vlerësimi</b>	Individual Në grup	Individual Në grup	Individual Në grup
<b>Shënimet e vlerësimit të projektit</b>	Plotësohen shënimet sipas niveleve të vlerësimit.	Plotësohen shënimet sipas niveleve të vlerësimit.	Plotësohen shënimet sipas niveleve të vlerësimit.

## Tema e projektit: “Të ushqehemi shëndetshëm”



Rezultatet e të nxënit:

- ✓ Shpjegon se çfarë është një ushqyerje e mirë dhe rëndësinë e saj.
- ✓ Bën zgjedhjet e duhura ushqimore ndihmuar nga informacioni i marrë.
- ✓ Shpërndan informacionin e marrë edhe tek familjarët, të afërmit dhe miqtë.

Lëndët që integrohen	Temat për çdo orë	Nr. i orëve
Kurrikul me zgjedhje	1. Rëndësia e një ushqyerje të shëndetshme	2 orë
Dituri natyre	1. Ç’do të thotë të ushqehesh? 2. Fruta të stinës, lëngje për t’u pirë	1orë
Njohuri për shoqërinë	1. Pjata të servirura bukur	1 orë
Art pamor	1. Frutat e perimet në tryezën tonë	1 orë
Matematikë	1. Një ushqyerje ditore e ekuilibruar 2. Piramida e ushqimeve	2 orë
Edukim fizik	1. Loja e aromave e shijeve	2 orë
Gjuhë shqipe	1. Prezantimi përfundimtar i projektit	1 orë
Gjithsej		10 orë



Shtrirja kohore: Nëntor - dhjetor

Partnerët: Prindërit e nxënësve, të afërm, miq.

Mësuesja: EhsenKraja II-B

Numri i orëve gjithsej: 10 orë

Numri i nxënësve të përfshirë: 30 nxënës

Burimet e informacionit:

- Teksti: “Për një ushqyerje të shëndetshme” botim i IZHA-s
- Botime të tjera për të ushqyerit nga interneti, enciklopeditë për fëmijë etj.

## Përshkrim i veprimtarive të projektit

Hyrje

Një ushqyerje e duhur që nga foshnjëria vendos bazat për një shëndet të mirë. Në të kundërt, një dietë e pabalancuar mund të shkaktojë dëme për pjesën tjetër të jetës dhe i hap rrugën një grupi sëmundjesh të varura drejtpërdrejt nga zakonet ushqimore, si mungesa e vitaminave, anemitë, obeziteti etj. Për këto arsye ky projekt është mjaft i rëndësishëm për t’u zbatuar që në moshë të vogël.

Faza I: 2 orë

Rezultatet e të nxënit në lëndën me zgjedhje dhe në dituri natyre:

- ✓ Përshkruan rëndësinë e një ushqyerjeje të shëndetshme.
- ✓ Shpjegon se çfarë është një ushqyerje e mirë.
- ✓ Informon prindërit mbi fillimin e projektit, informacionin e marrë, si dhe kërkon mbështetjen e tyre në lidhje me temat.
- ✓ Liston lëndët ushqyese të domosdoshme për shëndetin.
- ✓ Tregon se në cilat ushqime gjenden lëndët ushqyese.
- ✓ Përshkruan sëmundjet që shkaktohen nga dietat e pabalancuara (me tepriçë ose me mungesë).

Nr. orëve	Lëndët	Metodat e përdorura	Përgjegjës	Koha
1.	Kurrikul me zgjedhje:  Rëndësia e të ushqyerit të shëndetshëm	Diskutim njohurish  Stuhi mendimesh  Shpjegim fjalori  Fjalëkryq	Mësuesi  Nxënësit	Nëntor
2.	Dituri natyre:  Ç'do të thotë të ushqehesh?	Hartë koncepti për lëndët ushqyese  Ilustrim me shembuj  Veprimtari praktike në grupe  Vizatim	Mësuesi  Nxënësit	Nëntor

Faza II: (4 orë)

Rezultatet e të nxënit në gjuhë shqipe:

- ✓ Liston frutat dhe vlerat që përmbajnë ato.
- ✓ Përgatit lëngje të ndryshme frutash.
- ✓ Përshkruan vlerat e lëngjeve të frutave.
- ✓ Krahason lëngjet e frutave natyrore me ato industriale duke gjetur të përbashkëtat e dallimet
- ✓ Liston perimet duke treguar se cilën pjesë të bimës përdor.
- ✓ Tregon vitaminat e fibrat e disa perimeve.
- ✓ Jep 6 këshilla për mënyrën e gatimit të perimeve.

Rezultatet e të nxënit në art pamor:

- ✓ Shpjegon se pse duhet një shumëllojshmëri ushqimi çdo ditë.
- ✓ Përdor llojet e vijave për të dhënë më shumë se 1 formë.
- ✓ Jep iluzionin e hapësirës duke përdorur mbivendosjen e objekteve në një plan.
- ✓ Krijon tonalitete dhe nuanca ngjyrash për të ruajtur vëllimin e objektit.

- ✓ Vlerëson punën më të mirë artistike.
- ✓ Sensibilizon të tjerët për rëndësinë e të ushqyerit të shëndetshëm.

Rezultatet e të nxënit në matematikë:

- ✓ Bën paraqitjen grafike për konsumimin e frutave, perimeve bishtajoreve gjatë një jave duke llogaritur mesataren.
- ✓ Përgatit grafikun e përdorimit të frutave e perimeve të freskëta sipas stinës.
- ✓ Ndërton piramidën ushqimore.
- ✓ Përshkruan piramidën ushqimore.

Nr. orëve	Lëndët	Metodat e përdorura	Përgjegjës	Koha
1.	Gjuhë shqipe:  Fruta të stinës, lëngje frutash për t'u pirë.  Perimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartë mendimesh</li> <li>- Punë e drejtuar</li> <li>- Punë në grup</li> <li>- Diagram Veni për lëngjet natyrore dhe artificiale të frutave</li> <li>- Diskutim idesh</li> <li>- Ditar dypjesësh (perimet/ vlerat ushqyese)</li> <li>- Shkrim i lirë: Receta ime me perime</li> </ul>	Mësues  nxënës	Nëntor
2.	Art pamor:  Frutat e perimet në tryezën tonë	Punë me grupe:  Natyrë e qetë: Frutat  Natyrë e qetë: Perimet  Poster: "Llojshmëria, sekreti për të pasur një shëndet të mirë"	Mësues  nxënës	Nëntor

3.	Matematikë:  Një ushqyerje ditore e ekuilibruar	Paraqitje grafike e vakteve për 1 javë 5 herë në ditë. Mesatarja  Vizatim e interpretim i diagrameve për frutat e perimet e stinës	Mësues  nxënës	Nëntor
4.	Matematikë:  Piramida ushqimore	Vizatim e interpretim i piramidës ushqimore	Mësues  nxënës	Nëntor

Faza III: (2 orë)

Rezultatet e të nxënit në edukim për shoqërinë:

- ✓ Përgatit pjata të modeluara bukur me fruta.
- ✓ Shërben bukur ushqimet në tryezë.
- ✓ Improvizon rolet klient/kamariet duke udhëzuar për përdorimin e ushqimeve të shëndetshme.

Rezultatet e të nxënit në edukim fizik, sporte dhe shëndet:

- ✓ Zbulon frutën ose perimen me të dhënat shqisore (me prekje, shije, nuhatje, shikim, dëgjim).
- ✓ Përshkruan frutat e perimet.
- ✓ Tregon se gjykimet personale mbi frutat e perimet mund të jenë të ndryshme, por përshkrimi i tyre bazuar në kriterin e shikimit, shijimit, dëgjimit e prekjen duhet të jetë i njëjtë.

Nr. i orëve	Lëndët	Metodat e përdorura	Përgjegjës	Koha
1.	Edukim për shoqërinë: Pjata të servitura bukur	Mozaik me fruta Mbretëresha e shijeve Dramatizim në restorant	Mësues nxënës	Dhjetor
2.	Edukim fizik, sporte dhe shëndet: Loja e aromave e shijeve	Lojë "Mbyll sytë, mbyll hundën dhe hap gojën" Shkrim i lirë Rrjet diskutimi	Mësues nxënës	Dhjetor

#### Faza IV: (2 orë)

Mënyra e prezantimit të projektit

Nr. i orëve	Lëndët	Metodat e përdorura	Përgjegjës	Koha
1.	Kurrikul me zgjedhje	Prezantimi përfundimtar i projektit	Mësues nxënës	Dhjetor
2.	Edukim fizik, sporte dhe shëndet	Këngë Ekspozitë punimesh Panair ushqimi Konkurs Dramatizim	prindër të ftuar	

#### Rezultate të pritshme

Presim nga projekti që të përfitojmë:

- ✓ Nxënës të ndërgjegjësuar për rëndësinë e të ushqyerit të shëndetshëm.

- ✓ Rritje të aftësive për të prodhuar një produkt të individëve e grupeve dhe për t'ua prezantuar atë të tjerëve.
- ✓ Rritje të bashkëveprimit mësues – nxënës - prind – shoqëri.
- ✓ Prindër më të përgjegjshëm për të ushqyerit.
- ✓ Pas aktiviteteve, nga grupi i zbatimit të projektit, do të përgatitet raporti përfundimtar dhe evidenca fotografike për projektin.

### **Buxheti i kërkuar**

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i aktivitetit</b>	<b>Kosto në lekë</b>
1.	Fruta	1000
2.	Perime	500
3.	Gota, pjata, thika, pirunë plastikë, letra	1000
4.	Materiale, foto, fletëpalosje, kanceleri	1000
5.	Organizim gare, koncerti dhe takimi përmbyllës	1500
<b>Totali</b>		<b>5000</b>

## PROJEKT NDËRLËNDOR “NË NDIHMË TË KOMUNITETIT”<sup>8</sup>



*Komuniteti, mjedisi ynë i përbashkët*

Klasa e tretë

Lëndët e përfshira në projekt:

- Qytetari (2 orë mësimore)
- Gjuhë shqipe (1 orë mësimore)

Kohëzgjatja: 3 orë mësimore

**Tema: Në ndihmë të komunitetit**

Qëllimi i projektit: T'u japim nxënësve mundësinë për të zhvilluar aftësitë e pjesëmarrjes qytetare si dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.

Kompetencat që zhvillohen:

- *Kompetenca qytetare*

Lënda e qytetarisë, si pjesë e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, përmes bashkëpunimit krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të *kompetencës qytetare*, si edhe në zhvillimin e kompetencave të tjera kyç.

---

<sup>8</sup> Suada Vokshi, Shkolla 9 - vjeçare “Branko Kadia” Shkodër

- *Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin*

Nxënësit zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin, me kompleksitetin e dukurive të tij duke vlerësuar rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri.

Nxënësit mësojnë të bashkëpunojnë, të marrin përgjegjësi ndërsa përballen me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim.

- *Kompetenca personale*

Lënda e qytetarisë nxit të nxënësit e bazuar në kërkim dhe veprimtari praktike duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten dhe bashkëpunuar me të tjerët. Nxënësit kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënësit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive, si dhe në marrjen e vendimeve. *Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.*

Rezultatet e të nxënësit:

- Zhvillon një projekt në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor me rëndësi për shkollën dhe për komunitetin.
- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social etj.) për realizimin e aktivitetit të përbashkët .

Metodologjia: bisedë, diskutim, punë në grupe, hulumtim, veprimtari praktike

Baza materiale: tabakë A6 dhe lapustilapër modelimin e një përparëseje prej letre dhe moton e shkruar në të, brusha dhe gëlqere për lyerje, doreza dhe plastmasë për grumbullimin e mbeturinave, bojë muri, aparat fotografik.

Partnerët: mësuesja, nxënësit e klasave të treta, 3 prindër



Buxheti: 500 lekë për bojërat dhe për gëlqeren

### Fazat e zhvillimit të projektit:

Faza e parë : *Njohja me temën e projektit dhe ndarja e detyrave* (1 orë)

- Njihen nxënësit me temën e projektit.
- Bëhet lidhja e kapitullit (Komuniteti ynë) me projektin që do të zhvillojmë.
- Nxënësit janë porositur ditë më parë (sipas grupeve) për të sjellë në klasë mjetet e paracaktuara (doreza, qese, kuti kartoni, brushë).
- Klasifikohen materialet dhe mjetet sipas grupeve dhe detyrave të nxënësve.
- Diskutohet për mënyrën se si do të vepohet në oborrin e shkollës dhe komunitetin përreth saj.

Faza e dytë: *Veprimtari praktike në komunitet* (2 orë)

→ Grupimi sipas funksioneve dhe detyrave:

Grupi I i punës - mbledhja e mbeturinave në oborrin e shkollës

Grupi II i punës - lyerja e bordurave me gëlqere

Grupi III i punës - lyerja e pemëve me gëlqere

Grupi IV i punës - vizatimi i mureve dhe lyerja me bojë

Grupi V – pastrimi i komunitetit (rrugicat) jashtë shkollës

Për çdo grup pune është parashikuar të ketë nga një prind dhe mësueset e klasave të treta.

- Monitorohen veprimtaritë me foto, të cilat pasqyrohen në një poster që do të përgatitet në vijim.
- Vlerësimi i nxënësve:
  - 1) Vlerësimi sipas klasave (korrektësia për bazën materiale dhe mjetet e punës)
  - 2) Vlerësimi në grupe pune (vlerësimi i punës në grup, bashkëpunimi)
  - 3) Vlerësimi individual (saktësia e kryerjes së detyrës individuale, komunikimi me anëtarët e grupit).

# Vlerësimi i projektit kurrikular për klasat IV dhe V

Tabela 28. Model i vlerësimit të një projekti gjithëvjeter

<i>Projekti është hulumtues/ kërkimor (shtrihet gjithë vitin)</i>				
<i>Projekti përmban gjithsej 40 pikë</i>				
<b>Kriteret e vlerësimit</b>	<i>Niveli 1 - Pamjaftueshëm</i> 0-10 pikë	<i>Niveli 2 - Mjaftueshëm</i> 11 - 21 pikë	<i>Niveli 3 – Mirë</i> 22- 32 pikë	<i>Niveli 4 – Shumë mirë</i> 33 -40 pikë
<b>Faza I</b>	<b>0-4 pikë</b>	<b>5-8 pikë</b>	<b>9-12 pikë</b>	<b>13-15 pikë</b>
<b>15 pikë</b>	Nxënësit:	Nxënësit:	Nxënësit:	Nxënësit:
<b>Demonstrimi i aftësive kërkimore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- rrallëherë fokusohen te detyra e tyre;</li> <li>- mbledhin informacione jo të përshtatshme;</li> <li>- përdorin një burim për të gjetur informacionin.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- dalin jashtë temës dhe nuk fokusohen vetëm te detyra e tyre.;</li> <li>- mbledhin informacione dhe përmbledhin ato;</li> <li>- përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- janë të fokusuar te detyra e tyre shumicën e kohës;</li> <li>- mbledhin informacion e dhe gjejnë zgjidhje standarde;</li> <li>- përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacion e.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- janë të fokusuar te detyra e tyre;</li> <li>- orientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë;</li> <li>- mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe krijojnë komente intuitive për të zgjidhur probleme;</li> <li>- përdorin shumëllojshmëri i informacionesh.</li> </ul>

<b>Faza II</b>	<b>0 -4 pikë</b>	<b>5- 8 pikë</b>	<b>9 - 12 pikë</b>	<b>13 - 15 pikë</b>
<b>15 pikë</b>  <b>Realizimi i kërimit të gjetur</b>	Nxënësit:  - rrallëherë përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërimit; - informacioni i gjetur shpeshherë është jo i saktë.	Nxënësit:  - ndonjëherë përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërimit, por jo në mënyrë të vazhdueshme; - shtjellojnë i kërimit është me gabime.	Nxënësit:  - zakonisht përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërimit të pështatshme dhe efektive. - Shtjellimi i kërimit përmban pak gabime.	Nxënësit:  - përdorin gjatë gjithë projektit përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërimit të përshtatshme dhe efektive. - Shtjellimi i kërimit është i saktë dhe i qartë.
<b>Faza III</b>  <b>10 pikë</b>  <b>Prezantimi në mënyrë efektive i projektit</b>	<b>0-2 pikë</b> - Prezantimi i materialit është i ç'organizuar dhe rrëmujë. - Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri -tjetrin. - Prezantohen pak rezultate të projektit.	<b>3 -5 pikë</b> - Prezantimi i materialit është i organizuar mirë. - Prezantimi jo gjithmonë të krijon lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari. - Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.	<b>6-8 pikë</b> - Prezantimi i materialit është organizuar mirë. - Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.	<b>9-10 pikë</b> - Prezantimi i materialit është organizuar shumë mirë. - Rezultatet e projektit prezantohen qartë.

Tabela 29. Tabelë e vetëvlerësimit të projektit kurrikular nga nxënësi

Projekti kurrikular					
Gjithsej 40 pikë (nëse projekti shtrihet gjithë vitin)					
Kriteret e vlerësimit	Treguesi	ShM	M	Mj	Pmj
<b>Faza I - 15 pikë</b>  <b>Demonstrimi i aftësive kërkimore</b>	- Bashkëpunimi dhe kryerja e detyrave në grup				
	- Përdorimi i shumëllojshmërisë së informacioneve				
	- Fokusimi te detyra e dhënë				
	- Mbledhja e informacioneve të përshtatshme për detyrën				
<b>Faza II - 15 pikë</b>  <b>Realizimi i kërkimit të gjetur</b>	- Përdorimi gjatë projektit i aftësive kërkimore të përshtatshme dhe efektive				
	- Përdorimi i informacionit të gjetur për demonstrim				
<b>Faza III - 10 pikë</b>  <b>Prezantimi në mënyrë efektive i projektit</b>	- Organizimi i materialit që të krijoj lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari				
	- Prezantimi i qartë i rezultateve të projektit.				
	- Kontributi pozitiv në progresin e grupit.				

**Kujdes:** Projekti synon të masë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet në fund të periudhës dhe të vitit shkollor, por edhe formimin e kompetencave kyç dhe lëndore. Mësuesi është ai që vendos në bashkëpunim me nxënësit, temat e projekteve, lëndët që do të integrohen, kohëzgjatjen dhe fazat në të cilat do të zhvillohet projekti.



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË  
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



Rruga "Naim Frashëri"  
Nr. 37  
Tirana  
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

[www.ascap.edu.al](http://www.ascap.edu.al)